



# **RAPORT**

**Për mbikëqyrjen e administrimit të  
shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së  
nëpunësit civil në kushtet e zgjedhjeve për  
Kuvendin e Shqipërisë**

**25 Mars - 25 Prill 2021**

**Tiranë, Qershor 2021**

## **PËRMBAJTJA**

<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>3</b>
<b>PËRMbledhje ekzekutive e procesit të monitorimit të administrimit të shërbimit civil dhe sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore dhe bashkëpunimi me komisionin qendror të zgjedhjeve</b>	
<b>KAPITULLI II .....</b>	<b>8</b>
<b>Përgatitja e procesit të monitorimit dhe ngritja e grupeve të punës për realizimin e tij në bashkëpunim me institucionet që punësojnë nëpunës civilë</b>	
<b>KAPITULLI III.....</b>	<b>12</b>
<b>ndërrhyrja e komisionerit për të unifikuar praktikën dhe qëndrimet e grupeve të monitorimit në raport me sjelljen e nëpunësve civilë në aspekte të veçanta të administrimit të shërbimit civil</b>	
<b>KAPITULLI IV .....</b>	<b>15</b>
<b>Monitorimi i prezencës në punë dhe situata e evidentuar sipas të dhënave të administruara</b>	
1. Tipologjia e institucioneve të përfshira në proces dhe disa të dhëna për numrin e nëpunësve civilë të monitoruar .....	15
2. Situata e konstatuar në lidhje me prezencën në punë, sipas informacioneve të raportuara nga Grupet e Monitorimit .....	16
3. Situata e konstatuar nga verifikimi në subjekt, nëpërmjet sondazheve ditore të grupeve të ngritura nga Komisioneri .....	20
4. Respektimi i të drejtës për të marrë pjesë në zgjedhje me statusin e kandidatit për deputet, si dhe për të marrë pjesë në administratën zgjedhore .....	21
<b>KAPITULLI V.....</b>	<b>25</b>
<b>Verifikimi i informacionit të marrë nga media dhe nga denoncimet e qytetarëve</b>	
<b>KAPITULLI VI.....</b>	<b>30</b>
<b>Administrimi i shërbimit civil në lidhje me disa institute të ligjit për nëpunësin civil të aplikuar gjatë procesit zgjedhor</b>	
1. Pezullimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit, pasi nëpunësi civil është regjistruar si kandidat për zgjedhjet politike .....	30
2. Emërimet në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, për periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore.....	30
3. Rastet e emërimeve në shërbimin civil, në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil, për periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore .....	32
4. Rastet e përfundimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, gjatë periudhës së monitorimit.....	34
5. Aplikimi i institutit të transferimit në shërbimin civil, gjatë periudhës së monitorimit.....	35
6. Kallëzimet penale .....	35
<b>KAPITULLI VII .....</b>	<b>37</b>
<b>Konkluzione dhe rekomandime</b>	

## KAPITULLI I

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E PROCESIT TË MONITORIMIT TË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL DHE SJELLJES SË NËPUNËSIT CIVIL GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE DHE BASHKËPUNIMI ME KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

⇒ *Historiku i zhvillimit të procesit dhe risitë e bazës ligjore mbi të cilën është vlerësuar sjellja e nëpunësit civil*

Nisma e Komisionerit për të kontribuar në ndryshimin e sjelljes së administratës publike gjatë proceseve zgjedhore, drejt standardeve evropiane; në zbatim të parimeve të administrimit të shërbimit civil; me qëllim që administrata të orientohet drejt zbatimit të detyrave funksionale në shërbim të shtetit dhe publikut dhe jo në ndihmë të subjekteve zgjedhore, është përkrahur dhe është vlerësuar nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutat e miratimit të veprimtarisë së Komisionerit për vitet 2017 dhe 2019 si një proces i frytshëm dhe i dobishëm në drejtim të respektimit të ligjit për nëpunësin civil dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Po kështu veprimtaria e Komisionerit në këtë aspekt të zbatimit të ligjit, është vlerësuar edhe nga organizmat ndërkombëtare si OSBE – ODHIR dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, të cilat e kanë mbështetur Komisionerin në këtë proces.

Duke vlerësuar praktikën e mirë të punës që është kryer në këtë drejtim, si dhe faktin se për zgjedhjet është kritike që administrata publike të mbajë standardet më të larta ligjore dhe etike të sjelljes, duke siguruar që përgatitjet zgjedhore të vazhdojnë pa probleme dhe të gjithë qytetarët të gëzojnë lirisht të drejtat e tyre politike, Komisioneri e ka përfshirë këtë proces në planin e veprimtarisë së tij për vitin 2021.

Rëndësia e këtij procesi u theksua edhe në pikën 6 të Rezolutës së Kuvendit për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për vitin 2020, miratuar në datën 3.6.2021, ku është lënë si detyrë që, Komisioneri në bashkëpunim me institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësve civilë gjatë periudhës zgjedhore për vitin 2021 dhe t'i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë.

Procesi i monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, përgjatë fushatës elektorale, ka nisur me Urdhrin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nr. 13 (141 prot.), datë 11.02.2021, “Për krijimin e grupit të gatshëm me objekt veprimtarie, monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore”, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në detyrat e ngarkuara me rezolutën e Kuvendit.

Në këtë proces, janë vendosur kontaktet me **200** institucione të administratës publike, nga të cilat: **114** institucione të administratës shtetërore (**12** institucione të administratës shtetërore: Kryeministria dhe 11 Ministritë e linjës; **90** institucione varësie dhe **12** prefektura); **73**

institucione të vetëqeverisjes vendore (*12 Këshilla Qarku dhe 61 Bashki*) dhe **13** institucione të pavarura dhe janë përfshirë **12896** pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Gjatë këtij procesi Komisioneri ka qenë në rolin e koordinatorit të Grupeve të Posaçme të Monitorimit, të cilat u ngritën nga subjektet e sistemit të shërbimit civil, menjëherë pas kërkesës së Komisionerit dhe kanë vijuar raportimet për situatën e konstatuar për çdo ditë, në kohë reale.

Institucionet u asistuan nga stafi i Komisionerit në drejtim të përgatitjes së modeleve të akteve për funksionimin e Grupeve të Monitorimit dhe metodologjisë së punës së tyre, si në drejtim të hartimit të rregullores së brendshme, ku u përcaktuan qartë edhe të drejtat dhe detyrat e nëpunësit civil gjatë periudhës së monitorimit, si dhe procedura që do të ndiqej për monitorim, nëpërmjet akt konstatimeve dhe raportimit ditor pranë inspektorit të ngarkuar me këtë detyrë. Të gjithë nëpunësit civilë të institucionit, morën dijeni për përmbajtjen e rregullores, si dhe për modelet e akteve të konstatimit, ku u përcaktua, midis të tjerave, edhe frekuenca e kontrolleve gjatë ditës. Për shkak të rrethanave specifike në të cilat u realizua procesi i mbikëqyrjes, të kushtëzuara nga prania e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19, u orientuan institucionet që të përfshinin në rregulloren e Grupeve të Monitorimit edhe rregullat e vendosura nga akti normativ për punën në distancë.

Grupet e Monitorimit, u paraqitën si organizma me përgjegjësi të plota administrative dhe disiplinore për të raportuar informacion të saktë dhe të dhëna të rakorduara pranë Komisionerit. Mbi bazën e këtij informacioni, Komisioneri ka vijuar me përpunimin e të dhënave dhe vlerësimin e situatës.

Po kështu, për aq sa e ka pasur të mundur, Komisioneri ka ushtruar inspektive ditore në subjekt, ashtu si parashikohej edhe në urdhrin e posaçëm të Komisionerit që rregulloi këtë proces, çka do të sqarohet më tej në përmbajtjen e këtij raporti.

Roli i Komisionerit ka qenë vendimtar në këtë proces, sidomos nëpërmjet udhëzimeve të veçanta, sipas nevojës që identifikohet në drejtim të unifikimit të qëndrimeve të institucioneve që punësojnë nëpunës civilë, në lidhje me institute të ndryshme të ligjit për nëpunësin civil, sidomos në drejtim të të drejtave dhe detyrave të nëpunësve civilë gjatë një periudhe zgjedhore; konfliktit të interesit; institutit të pezullimit; institutit të disiplinës në shërbimin civil; sjelljen e nëpunësit civil në rrjetet sociale, çka është edhe një aspekt i pa rregulluar në mënyrë të shprehur nga ligji; si edhe me çështje të tjera të administrimit të shërbimit civil.

Gjatë këtij procesi, Komisioneri ka trajtuar ankesat dhe informacionet që kanë ardhur pranë këtij institucioni për çështje të ndryshme, për të cilat ka dalë me vendime të arsyetuara.

Monitorimi dhe zgjidhja e ankesave, janë dy procese që vlerësohen së bashku në këtë rast, si në drejtim të parregullsisë, por edhe të arritjeve të administratës, që tregoi përgjegjshmëri dhe maturi me sjelljen gjatë periudhës zgjedhore, por edhe me ndihmën që dha në drejtim të pjesëmarrjes në organet zgjedhore, të ngritura nga KQZ.

Të gjitha çështjet e trajtuara në këtë raport, si denoncimet e përcjella në subjekt nga ana e Komisionerit, ashtu dhe ekzekutimi i vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, të marra gjatë periudhës zgjedhore, janë duke u ndjekur në vijimësi nga Komisioneri.

Komisioneri vlerëson se risia e procesit për këtë vit, është krijimi i bazës ligjore për të rregulluar në mënyrë specifike procesin e monitorimit të sjelljes së administratës publike në përgjithësi dhe të shërbimit civil në veçanti, nëpërmjet ndryshimeve ligjore, si edhe akteve të posaçme të dala nga një institucion kompetent në administrimin e procesit zgjedhor, tashmë i reformuar dhe i vendosur tërësisht në rolin e tij, nëpërmjet mekanizmave (*Komisionerit dhe Komisioneve*) që veprojnë në përbërje të tij, që është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Bëhet fjalë për ndryshimet ligjore në Kodin Zgjedhor dhe për Vendimin e Komisionit Rregullator të KQZ, nr. 9, datë 24.12.2020, “*Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve*”, akte të cilat përbëjnë tashmë pikën e referimit për të përcaktuar ndalimet; detyrimet dhe të drejtat e nëpunësve të shërbimit civil në situata zgjedhore, të cilat janë të harmonizuara edhe me rregullimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar. Grupet e monitorimit u orientuan që këtë vendim, ta bëjnë pjesë të rregullores së funksionimit të tyre si në drejtim të bazës ligjore të funksionimit ashtu edhe në drejtim të specifikimit të rregullave të vendosura për nëpunësit civilë.

Udhëzimet e Komisionerit gjatë zgjedhjeve të mëparshme, si edhe rekomandimet në përmbajtjen e raporteve përfundimtare për vlerësimin e sjelljes së nëpunësit civil, për periudhat zgjedhore gjatë vitit 2017 dhe vitit 2019, janë vlerësuar dhe janë marrë parasysh, pasi janë materializuar në dispozitat e Kodit Zgjedhor të ndryshuar, si dhe në përmbajtjen e akteve rregullative që kanë dalë gjatë procesit zgjedhor, gjatë vitit 2021, që kanë lidhje me nëpunësin civil.

#### ⇒ *Bashkëpunimi me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve*

Bashkëpunimi me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka nisur me shkresën nr. 397 prot., datë 09.03.2021, drejtuar Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, përmes së cilës është paraqitur një informacion në lidhje me masat e marra nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të zhvillimit normal të procesit zgjedhor, në përputhje edhe me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, përgjatë fushatës zgjedhore.

Me qëllim zbatimin e drejtë dhe të unifikuar në praktikë të ligjit, gjatë kësaj periudhe, Komisioneri ka përgatitur udhëzime të posaçme, duke sqaruar dhe orientuar institucionet, për mënyrën se si duhet të veprojnë për çdo rast, sidomos a) në drejtim të respektimit të të drejtave

politike të nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor; **b)** evitimin e pengesave të krijuara nga institucionet për pjesëmarrjen e kategorisë së nëpunësit civil në administratën zgjedhore të emëruar nga KQZ, si dhe **c)** në drejtim të vlerësimit të veprimtarisë së nëpunësit civil në rrjetet sociale, si aspekt që aktualisht nuk ka një rregullim specifik ligjor, duke theksuar detyrimin për vetëpërmbytje dhe për të respektuar kërkesat e ligjit, në rast publikimi në statuset e tyre. Për të gjitha këto aspekte, është informuar edhe institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si në aspektin e një prej institucioneve të pavarura që punëson nëpunës civilë, ashtu edhe në cilësinë e institucionit që administron procesin zgjedhor.

Me qëllim që në raportim të përfshihen gjithë të dhënat që kanë lidhje me procesin e monitorimit, Komisioneri ka vijuar bashkëpunimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke i kërkuar këtij institucioni, nëpërmjet shkresës nr. 616 prot., datë 11.05.2021, informacion në lidhje me denoncimet që kanë si objekt shkelje të kryera gjatë procesit zgjedhor, nga nëpunësit civil të çdo niveli të administratës publike, të hetuara apo që janë në fazë hetimi nga ky institucion.

Përgjigja e kësaj kërkesë ka ardhur me shkresën nr. 5203/1 prot., datë 21.05.2011, të KQZ-së, me anë të së cilës është përcjellë informacion për të gjitha denoncimet e administruara pranë tyre, duke evidentuar pamundësinë e institucionit për të diferencuar rastet që kanë lidhje me shërbimin civil.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri e ka përpunuar materialin dhe rezulton se nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë trajtuar **10** denoncime për punonjës të administratës publike, nga të cilët në **3** raste, këta punonjës kanë qenë pjesë e shërbimit civil.

Bëhet fjalë për denoncimet e shqyrtuara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

- me vendimin nr. 351, datë 05.05.2021, për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë Drejtor në Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës, Vlorë;
- me vendimin 350, datë 05.05.2021, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Vlorë;
- me vendimin nr. 233, datë 14.04.2021, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm në Prefekturën e Qarkut Dibër.

Në të gjitha këto raste, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi ka analizuar rrethanat e çështjes, ka vendosur përfundimin e shqyrtimit administrativ të kallëzimit ndaj punonjësve, pasi nuk janë konstatuar shkelje të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Po kështu, si pjesë e informacionit të dërguar nga KQZ, janë edhe **20** denoncime që janë ende në proces hetimi administrativ nga ky institucion, nga analiza e të cilave rezulton se në **1** rast, punonjësi i denoncuar, është i punësuar në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil. Ecuria e këtij procesi do të ndiqet nga Komisioneri, për të vepruar më tej me verifikimin e rastit, në varësi të vendimit që do të marrë KQZ.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, Komisioneri vlerëson si nivelin e lartë të bashkëpunimit me institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë procesit zgjedhor, ashtu edhe ndërhyrjen e këtij institucioni, nëpërmjet akteve rregullative për të unifikuar qëndrimin në lidhje me respektimin dhe përcaktimin e kufijve të të drejtave politike që gëzojnë nëpunësit civilë gjatë procesit zgjedhor, duke lehtësuar procesin e hetimit administrativ të çdo rasti të pretenduar në shkelje të ligjit, sidomos në drejtim të identifikimit të llojit dhe rëndësisë së shkeljes disiplinore.

## KAPITULLI II

### PËRGATITJA E PROCESIT TË MONITORIMIT DHE NGRITJA E GRUPEVE TË PUNËS PËR REALIZIMIN E TIJ NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONET QË PUNËSOJNË NËPUNËS CIVILË

Duke vlerësuar faktin se, institute të ndryshme të ligjit për nëpunësin civil do të bëheshin efektiv gjatë fushatës zgjedhore, të tilla si pezullimi, masat disiplinore, si dhe realizimi i veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë, *(në kuadrin e pjesëmarrjes së tyre në administratën zgjedhore)*, me qëllim që:

- të orientoheshin drejt njësitë përgjegjëse, të ngarkuara me administrimin e burimeve njerëzore, për të menaxhuar situatën që krijohet për shkak të rrethanave specifike të diktuar nga një eksperiencë zgjedhore, të vlerësuara nga Komisioneri, me një nivel të lartë risku, që mund të sjellë si pasojë uljen e efikasitetit, apo përfshirjen e nëpunësit civil në fushatën elektorale, për llogari të forcave të ndryshme politike, çka vjen në kundërshtim me parimin e paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i shërbimit civil *(neni 5, Kreu II, i ligjit në fjalë)*;
- të sigurohej zbatimi i ligjit, në drejtim të respektimit të të drejtave politike të nëpunësit civil, e njëkohësisht edhe të kufizimeve të vendosura në dispozitën që përfaqësohet nga neni 37, i ligjit në fjalë, ku ndër të tjera, ndalohet pjesëmarrja e tij në veprimtari politike gjatë orarit zyrtar, si dhe shprehja publikisht e bindjeve apo preferencave politike;
- të sigurohej vijueshmëria normale dhe e pandikuar nga fushata zgjedhore, e veprimtarisë së trupës së nëpunësve civilë, në shërbim të shtetit dhe qytetarëve dhe të mbështetjes institucionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga nëpunësit civilë, nëpërmjet pjesëmarrjes në administratën zgjedhore;

Komisioneri kërkoi nga institucionet që punësojnë nëpunës civilë, që të merreshin masat e menjëhershme, për të vendosur kontrollin mbi veprimtarinë dhe sjelljen e nëpunësve civilë, në përputhje me ligjin, në këtë situatë specifike.

Në rolin e koordinatorit midis institucioneve të tipologjive të ndryshme, Komisioneri filloi përgatitjet për monitorimin e këtij procesi, në muajin shkurt të vitit kalendarik në vijim, me urdhrin e brendshëm nr. 13 (141 prot.), datë 11.02.2021, *“Për krijimin e grupit të gatshëm me objekt veprimtarie, monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore”*. Nëpërmjet këtij akti, u ngrit struktura e grupit të gatshëm, në përbërjen e të cilit u përfshinë të gjithë anëtarët e Sekretariatit të Komisionerit.

Bashkëpunimi me subjektet ka nisur fillimisht me një Udhëzues, nëpërmjet të cilit, Komisioneri i është drejtuar një tipologjie të caktuar të institucioneve që punësojnë nëpunës civilë, duke i përzgjedhur mbi bazën e nivelit të riskut për të krijuar probleme në veprimtarinë



e administratës në tërësi dhe të shërbimit civil në veçanti, në këtë situatë specifike, duke përdorur si indikatorë për përfshirjen e tyre, kryesisht, numrin e punonjësve (*institucione me një numër relativisht të lartë punonjësish*), shtrirjen e gjerë territoriale të tyre, si dhe nivelin e ndikimit të tyre në administratën publike.

Në këtë kategori janë përfshirë Kryeministria, Ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë (*administrata shtetërore*); njësitë e qeverisjes vendore (*Bashkitë dhe Këshillat e Qarkut*), si edhe institucionet e pavarura, të cilat u njohën me përmbajtjen e këtij udhëzuesi, si dhe u orientuan në lidhje me procedurën që do të ndiqet për të siguruar ecurinë dhe efikasitetin e procesit të monitorimit.

Më tej, megjithëse u konstatua një vullnet i plotë dhe reagim i menjëhershëm i institucioneve për të bashkëvepruar me Komisionerin, nga ana tjetër u evidentua se, disa prej këtyre institucioneve paraqitën vështirësi gjatë zhvillimit të procesit, çka u pasqyrua në kërkesat për asistencë në lidhje me aktet administrative që do ta vendosnin atë në korniza procedurale.

Për këtë qëllim, Komisioneri përgatiti draftin e urdhrin të brendshëm për ngritjen e grupit të punës, si dhe draft-rregulloren e veprimtarisë së grupit të monitorimit, akte të cilat i dërgoi pranë këtyre institucioneve, me qëllim që të ndihmohej, standardizohej dhe unifikohej veprimtaria e tyre gjatë këtij procesi.

Grupet e Monitorimit u orientuan që në rregulloren e brendshme të përcaktonin objektin e veprimtarisë së tyre, si dhe vendosjen e disa rregullave të hollësishme, të cilat duhet të ndiqeshin nga nëpunësit civilë gjatë periudhës së fushatës elektorale, e që më pas, ishin edhe objekti i kontrollit të grupit *ad-hoc* të ngritur në këtë rast.

Objekti i veprimtarisë së këtij grupi u përcaktua sjellja e nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale, që ka të bëjë me realizimin e detyrave të tyre funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve, si dhe zbatimin e disiplinës formale në punë.

Përbërja e grupit të punës u kërkua që të ndërtohej mbi bazën e specifikave të institucionit, në varësi të numrit të punonjësve të monitoruar dhe shtrirjes territoriale të institucioneve. Në këto grupe u kërkua që të merrnin pjesë në mënyrë të detyrueshme drejtuesit e njësisë së administrimit të burimeve njerëzore të institucionit, të cilëve duhej t'i përcaktohej një rol i rëndësishëm në këtë proces. Po kështu, u kërkua që njëri prej anëtarëve të grupit të emërohej edhe si koordinator që do të mbante kontaktet me palët e interesuara.

Grupi i Monitorimit u orientua që të vepronte në bashkëpunim të ngushtë me eprorët direkt të nëpunësve civilë, si dhe me njësinë e administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të respektohej diskrecioni ligjor i këtyre subjekteve, në rastet e përcaktuara shprehimisht në ligj. *Puna për realizimin me sukses të objektivit të këtij grupi u orientua nga Komisioneri, në disa aspekte, të cilat u përcaktuan si të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë nëpunësit civilë të institucionit.*

- Në një regjistër të posaçëm, i cili do të administrohet nga Grupi i Monitorimit, nëpunësit civilë duhet të shënojnë çdo ditë hyrje - daljet në institucion, destinacionin, si dhe eprorin që e ka miratuar lejen për të lëvizur nga vendi i punës, duke filluar nga ora 08.00 -16.00, apo në përputhje me orarin zyrtar të institucionit.
- Nga ana e njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, duhet të shënohen në orën 8.00, të gjithë nëpunësit civilë që janë me shërbim jashtë institucionit, destinacioni si dhe akti administrativ me të cilin është autorizuar lëvizja.
- Në fund të çdo dite pune, deri në përfundim të fushatës elektorale, listëprezenca e nëpunësve civilë do të nënshkruhet nga Grupi i Monitorimit dhe do të bëhet pjesë e dokumentacionit që do të materializojë veprimtarinë e tij.
- Nëpunësit duhet të jenë në çdo moment të gatshëm për t'u përgjigjur në telefon, me qëllim që të mundësohet mbikëqyrja e vendndodhjes së tyre, gjatë sondazheve të realizuara nga Grupi i Monitorimit. Për këtë arsye, ata duhet të regjistrojnë numrat e telefonit, pranë njësisë së administrimit të burimeve njerëzore.
- Eprorët direkt duhet të jenë në çdo rast në dijeni të lëvizjes së stafit të tyre, në të kundërt, mospasja dijeni për mungesa të stafit, do të konsiderohet si mospërmbushje e detyrave funksionale nga ana e tyre.
- Gjatë orarit zyrtar 8.00 deri 16.00 (*ose orari i vendosur nga disa institucione, i ndryshëm nga orari klasik, për shkak të specifikave të tyre*), nëpunësit civilë nuk duhet të marrin pjesë në asnjë veprimtari apo organizim politik, të tilla si mitingje apo të ndonjë natyre tjetër, për llogari të forcave të ndryshme politike, pjesëmarrëse në zgjedhje.
- Nëpunësi civil nuk duhet të bëhet pjesë e diskutimeve politike, brenda ambienteve të institucionit, me kolegët apo qytetarët, të mos përdorë apo mbajë postera, fletëpalosje dhe objekte me simbole të subjekteve politike në ambientet e institucionit, të mos lejojë përdorimin apo mbajtjen e posterave, fletëpalosjeve dhe të simboleve të subjekteve politike, nga qytetarët që kryejnë shërbime në ambientet e institucionit.
- Nëpunësi civil të informojë grupin e monitorimit në rastet kur konstaton shkelje të kësaj rregulloreje.
- Pas orarit zyrtar, nëpunësi civil nuk duhet të shprehet publikisht për bindjet apo preferencat politike, gjatë organizimit të veprimtarive të ndryshme politike, nga forca të ndryshme politike.
- Grupi i Monitorimit do të organizojë kontrolle në frekuenca të shpeshta gjatë orarit zyrtar, të cilat do të materializohen në procesverbale, ku nëpunësit prezent në punë, duhet të nënshkruajnë në mënyrë individuale në këto akte, të cilat më pas do të administrohen si pjesë e veprimtarisë së këtij grupi.
- Grupi i Monitorimit, nëpërmjet koordinatorit të emëruar nga ky grup, do të komunikojë çdo ditë me personin e kontaktit, pjesë e Grupit të Gatshëm, të ngritur pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe do të përcjellë në kohë reale orientimet e këtij institucioni, me qëllim që të monitorohet sa më objektivisht situata dhe të zgjidhen në kohë problemet që dalin gjatë procesit të monitorimit.
- Grupi i Monitorimit do të ndjekë me vëmendje transmetimet në media, me qëllim që të evidentojë çdo rast të sjelljes së nëpunësit civil në kundërshtim me ligjin.

- Të gjitha rastet e konstatuara me shkelje, Grupi i Monitorimit do t'i dërgojë për fillimin e ecurisë disiplinore, pranë eprorit direkt, ose pranë Komisionit të Disiplinës, sipas rëndësisë së shkeljes së kryer.

Dispozitat e kësaj rregulloreje, u konsideruan si të detyrueshme për t'u zbatuar nga grupi i monitorimit, si dhe nga nëpunësit civilë të institucionit, të cilët u njohën me këtë akt, nëpërmjet njësisë së administrimit të burimeve njerëzore, me qëllim që të mundësohej zbatimi i rregullave të vendosura në përmbajtje të tij.

Në këtë rregullore u përcaktua afati i fuqisë së saj ligjore, duke specifikuar se hyrja në fuqi lidhej me ditën e miratimit nga titullari i institucionit (*drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore dhe Sekretari i Përgjithshëm për ministritë*) dhe se, ajo ishte e vlefshme vetëm për periudhën zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 2021.

Pas kësaj ndërhyrjeje të Komisionerit, rezultoi një përgjigje e menjëhershme e institucioneve, duke u ngritur **200** Grupe Monitorimi, të cilët, në mënyrë korrekte, kanë komunikuar në vijimësi, gjatë gjithë periudhës zgjedhore, me Komisionerin, nëpërmjet koordinаторit të emëruar nga titullari i institucionit dhe në përbërjen e tyre kanë vepruar **669** nëpunës civilë.

***Tabela nr.1** Pjesëmarrja e nëpunësve civilë në Grupet e Monitorimit*

<b>Institucionet e përfshira në monitorim</b>	<b>Punonjësit që kanë marrë pjesë në Grupet e Monitorimit</b>
<b><i>Administrata Shtetërore</i></b> <b>(1)</b>	
Kryeministri dhe Ministritë e Linjës Institucionet e varësisë Prefekti i Qarkut	346
<b><i>Njësitë e Qeverisjes Vendore</i></b> <b>(2)</b>	
Bashki Këshill Qarku	275
<b><i>Institucionet e pavarura</i></b> <b>(3)</b>	
Institucionet e pavarura	48
<b>TOTAL</b> <b>(1 + 2 + 3)</b>	<b>669</b>

Nga sa është paraqitur në të dhënat më sipër, Komisioneri e vlerëson nivelin e lartë të bashkëpunimit me institucionet gjatë këtij procesi dhe gatishmërinë e tyre për të informuar Komisionerin për çdo informacion të kërkuar në lidhje me proceset e monitoruara.

## KAPITULLI III

### NDËRHYRJA E KOMISIONERIT PËR TË UNIFIKUAR PRAKTIKËN DHE QËNDRIMET E GRUPEVE TË MONITORIMIT NË RAPORT ME SJELLJEN E NËPUNËSVE CIVILË NË ASPEKTE TË VEÇANTA TË ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Duke u nisur nga nevojat që u evidentuan gjatë procesit zgjedhor, për të standardizuar sjelljen e nëpunësve civilë në raport me aktivizimin e tyre në takimet elektorale të subjekteve zgjedhore si në terren dhe në rrjetet sociale, apo pjesëmarrjen e tyre në administratën zgjedhore, Komisioneri pasi e vlerësoi situatën, ka vepruar duke ndërhyrë në disa aspekte:

#### ⇒ Unifikimi i qëndrimit dhe vendosja e rregullave për rastet e publikimit të veprimtarive zgjedhore nga ana e nëpunësve civilë në rrjetet sociale

Në vijim të procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civil gjatë periudhës zgjedhore, si dhe duke marrë shkak nga disa kërkesa të institucioneve për interpretim të sjelljes së nëpunësve civilë në rastet e publikimit nga ana e tyre në rrjetet sociale, të veprimtarive zgjedhore të zhvilluara nga subjektet në garë, në raport me të drejtat dhe detyrimet e tyre, në fushën e shprehjes publike të bindjeve politike, Komisioneri ka publikuar qëndrimin e tij në lidhje me këtë aspekt dhe ka orientuar institucionet e monitoruara se si duhet të veprojnë në raste të tilla.

Për shkak të rrethanave specifike në të cilat u zhvillua procesi i zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021, si pasojë e rregullave të vendosura nëpërmjet urdhrin nr.132, datë 08.03.2021, të Ministrit të Shëndetësisë, “*Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jo publike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura*”, i cili ndaloi aktivitetet publike dhe jopublike, si dhe grumbullimet masive në vende të mbyllura dhe jo të mbyllura, nga ana e disa institucioneve, ndër të cilat edhe Avokati i Popullit, është kërkuar ndërhyrja e Komisionerit për të unifikuar qëndrimin, për rastet e përdorimit të rrjeteve sociale për fushatë, nga ana e nëpunësve civile të administratës publike.

Nisur nga një përkufizim i përgjithshëm që mund t’i bëhet rrjeteve sociale apo platformave sociale si, “*Facebook*”, “*Twitter*”, “*Instagram*”, “*WhatsApp*”, etj., Komisioneri i ka vlerësuar ato si “*sheshe virtuale*”, të shprehjes së bindjeve apo preferencave politike, pasi këto mjete komunikimi të japin mundësi reale, që duke përdorur teknologjinë e internetit, nëpërmjet llogarive personale, të vendosësh, apo të ndash me të tjerët fotografi, filmime, mendime, lajme, reklama, propagandë politike etj., e në këtë këndvështrim, ato mund të shërbejnë si instrumente efektive për të shprehur dhe mbështetur një preferencë politike, e cila është e ndaluar për nëpunësin civil.

Platforma të tilla tashmë janë masivisht të aksesueshme nga përdoruesi jo vetëm nëpërmjet kompjuterit, por edhe nga mjete të tjera elektronike si telefonat celular, të cilat e shpërndajnë informacionin gjerësisht dhe në një kohë shumë të shpejtë.

Por, nga ana tjetër, fakti që funksionimi i këtyre platformave, aktualisht nuk ka një rregullim ligjor të përcaktuar, e për pasojë, nuk ka një siguri të matshme që të lidhë emrin apo të dhënat e përdoruesit, me një person konkret, që mund të jetë edhe subjekt i ligjit për nëpunësin civil, është vlerësuar nga Komisioneri si një aspekt që kërkon një kujdes të veçantë në trajtimin e rasteve kur evidentohen publikime të ndaluara në rrjetet sociale.

Në këto kushte, Komisioneri ka arritur në konkluzionin se përdorimi i rrjeteve sociale apo platformave sociale, ashtu si u evidentua më sipër, apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, për qëllime të propagandimit apo shprehjes publike të bindjeve dhe preferencave politike të nëpunësit civil, është i ndaluar, në referencë të përcaktimit të pikës 1, të nenit 37 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ndërkohë, është kërkuar nga Komisioneri që Grupet e Monitorimit, të tregojnë vëmendje të posaçme, duke i konsideruar konstatimet e tyre apo denoncimet e ardhura për publikime në kundërshtim me ligjin në rrjete sociale, për një nëpunës civil, si një arsye për të hetuar paraprakisht, nëse kjo është një indicie e qenësishme për të nisur një ecuri disiplinore në ngarkim të subjektit të denoncuar. Hetimi është orientuar sidomos në drejtim të saktësisimit të faktit, nëse subjekti i denoncuar është i njëjti person me përdoruesin e asaj llogarie në rrjet.

Për këto arsye, Komisioneri ka vlerësuar se në rregulloren e brendshme të funksionimit të Grupeve të Monitorimit, duhet të përfshihet edhe kufizimi për nëpunësit civil, për të mos shprehur publikisht bindjet apo preferencat e tyre politike, në rrjete apo portale sociale, në zbatim nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Komisioneri ka kërkuar që ky plotësim i rregullores, t’i njoftohet të gjithë nëpunësve civilë të institucionit, me qëllim që ata të jenë në dijeni për këtë rregull të vendosur, të cilin duhet ta respektojnë në të ardhmen.

Me qëllim që institucionet të njiheshin me qëndrimin e Komisionerit dhe për të unifikuar praktikën për këto raste, u komunikua me Grupet e Monitorimit përmes shkresës nr. 458 prot., datë 05.04.2021, “*Në vëmendjen tuaj, në lidhje me vlerësimin e sjelljes së nëpunësve civilë, në rastet e publikimit prej tyre të veprimtarive zgjedhore në rrjetet sociale*”.

⇒ **Sqarimi dhe interpretimi i përmbajtjes së nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, që parashikon të drejtat politike të nëpunësit civil, duke informuar për qëndrimin e mbajtur në këtë rast, nëpërmjet një shkrese zyrtare, e cila i është dërguar të gjitha institucioneve me qëllim që të unifikohet praktika në zgjidhjen e rasteve të ngjashme që mund t’i paraqiteshin çdo institucioni, gjatë kësaj periudhe specifike.**

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, e cila rregullon të drejtat politike të nëpunësve civilë, Komisioneri arriti në konkluzionin se, nëpunësit civilë, nuk kanë asnjë pengesë ligjore, që të marrin pjesë në organizime elektorale të subjekteve të ndryshme zgjedhore, por gjithmonë jashtë orarit zyrtar dhe duke u kujdesur që të ushtrojnë vetëkontroll për sa i përket manifestimit

në publik të pikëpamjeve politike dhe besnikërisë ndaj një force politike në jetën private. Qëndrimi i Komisionerit në këtë rast, iu njoftua të gjithë institucioneve të përfshira në proces.

⇒ **Unifikimi i qëndrimit, në lidhje me ligjshmërinë e pjesëmarrjes së nëpunësve civilë, në institucionet e administratës zgjedhore, (të tilla si KZAZ, KQV, GNV, Trajnerë të KQZ, Operatori ekonomik), për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi të ngritur për interpretim nga një numër i konsiderueshëm i institucioneve.**

Në këtë rast, duke vlerësuar faktin se krijimi i administratës zgjedhore është një proces i përcaktuar në Kodin Zgjedhor, me misionin për të përgatitur dhe administruar zgjedhjet, si dhe duke analizuar detyrat konkrete që realizojnë punonjësit gjatë veprimtarisë së tyre në këto mekanizma; si dhe procedurat që zbatohen gjatë procesit zgjedhor, Komisioneri vlerësoi se institucionet zgjedhore, kanë tipare të institucioneve të administratës publike, të rregulluara me një ligj të posaçëm, të cilat nuk kanë asnjë lidhje me aspektin e politizuar të zhvillimit të fushatës zgjedhore, nga subjektet zgjedhore, pavarësisht se për shkak të natyrës së procesit, propozimet për anëtarët e tyre vijnë nga subjekte politike. Për këtë arsye, nëpunësit civilë, nuk kanë asnjë pengesë ligjore për të marrë pjesë në administratën zgjedhore.

Qëndrimi i Komisionerit, i harmonizuar edhe me kërkesat e Vendimit nr. 9/2020 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të KQZ, iu njoftua të gjithë institucioneve të përfshira në procesin e monitorimit.

Ashtu si duket nga çka u evidentua më sipër, Komisioneri është kujdesur që të përgjigjet menjëherë për zgjidhjen e problemeve që kanë dalë gjatë procesit, me qëllim që të sigurohej zbatimi i ligjit dhe të mos lejoheshin interpretime të gabuara të tij, të cilat do të sillnin pasoja negative gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor.

Gjithashtu, të gjitha qëndrimet e Komisionerit, që kanë të bëjnë me administrimin e shërbimit civil gjatë fushatës zgjedhore, i janë njoftuar institucioneve në kohë reale, edhe nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare në internet, si edhe nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë të inspektorit të ngarkuar me mbikëqyrjen e institucionit, me koordinatorin e subjektit.

## KAPITULLI IV

### MONITORIMI I PREZENCËS NË PUNË DHE SITUATA E EVIDENTUAR SIPAS TË DHËNAVE TË ADMINISTRUARA

#### 1. *Tipologjia e institucioneve të përfshira në proces dhe disa të dhëna për numrin e nëpunësve civilë të monitoruar*

Në vijim të procesit të monitorimit, menjëherë pasi i është dhënë fuqi ligjore Grupeve të Monitorimit, nëpërmjet ngritjes së tyre me urdhër të titullarit të institucionit përkatës dhe më tej, pasi këto grupe kanë miratuar rregulloren e tyre të brendshme të funksionimit, ato kanë filluar të raportojnë pranë Komisionerit në datën 25.03.2021, me fillimin zyrtarisht të fushatës zgjedhore.

Nga ana e Komisionerit, u kërkua që Grupet e Monitorimit të raportojnë të dhënat ditore, në mënyrë elektronike, apo nëpërmjet postës zyrtare, pranë stafit të ngarkuar për të ndjekur ecurinë e procesit, nëpërmjet akt-konstatimit, ku do të paraqitej situata e prezencës në punë të punonjësve.

Me qëllim që të unifikohet raportimi dhe të përgjithësoheshin me lehtësi problematikat, nga ana e Komisionerit u hartua një dokument (*akt – konstatimi*), me të cilin u njohën të gjitha institucionet e përfshira në proces, ku u përcaktuan indikatorët dhe rubrikat e posaçme që duhet të plotësoheshin dhe rezultoi se subjektet iu përgjigjën me korrektesë këtyre kërkesave.

Sa më sipër, si dhe pas përmbylljes së kuadrit ligjor dhe procedural të procesit të ngritjes së grupeve të monitorimit dhe hartimit të rregulloreve të brendshme të veprimtarisë së tyre, Komisioneri ka kaluar në fazën tjetër të procesit të monitorimit, duke komunikuar në mënyrë periodike me grupet e monitorimit dhe duke i mbikëqyrur çdo ditë institucionet, nga inspektorët e grupit të gatshëm.

Rezultoi se grupet e monitorimit vepruan duke administruar regjistrin e posaçëm të prezencës së punonjësve sipas modelit të dërguar nga Komisioneri, ku u materializuan disa sondazhe në ditë për prezencën në punë të punonjësve, dy nga të cilat pasqyronin fillimin dhe mbarimin e orarit zyrtar dhe të tjerat, janë kryer në kohë të ndryshme, përgjatë orarit zyrtar.

Në përfundim të procesit zgjedhor, Komisioneri raporton se janë përfshirë në procesin e mbikëqyrjes 200 institucione, sipas kësaj tipologjie:

- ✓ **114** Institucione të administratës shtetërore:
- ✓ **73** Njësi të Qeverisjes Vendore (NJQV):
- ✓ **13** institucione të pavarura

Sipas statistikave që janë përpunuar nga Sekretariati i Komisionerit, rezulton se në mbikëqyrje janë përfshirë **12896** nëpunës civilë (nga rreth **16.000** që është numri total i nëpunësve në të

gjithë sistemin e shërbimit civil) të ndarë sipas tipologjisë së institucioneve, sipas tabelës më poshtë, në këtë mënyrë:

**Tabela nr. 2** Numri i punonjësve në institucionet e monitoruara

<b>Administrata shtetërore</b> <i>(Kryeministria dhe Ministritë, Prefekti i Qarkut Institucionet e varësisë)</i>	<b>Njësitë e Qeverisjes Vendore</b> <i>(61 Bashki dhe 12 Këshilla Qarku)</i>	<b>Institucione të pavarura</b>	<b>TOTALI</b> <i>(Nëpunës civilë të mbikëqyrur)</i>
<b>6818</b>	<b>5393</b>	<b>685</b>	<b>12896</b>

Procesi specifik i monitorimit të administrimit të shërbimit civil, dhe në mënyrë më të detajuar, i sjelljes dhe veprimtarisë së nëpunësve civilë, është kryer për një periudhë një mujore, që përkon edhe me fushatën zgjedhore, si përkufizim i Kodit Zgjedhor.

## **2. Situata e konstatuar në lidhje me prezencën në punë, sipas informacioneve të raportuara nga Grupet e Monitorimit**

Në përfundim të procesit zgjedhor, Sekretariati i Komisionerit, ka përpunuar një informacion voluminoz, në lidhje me aspekte të ndryshme të këtij procesi, të tilla si prezenca në punë gjatë orarit zyrtar, pjesëmarrja e nëpunësve civilë në administratën zgjedhore, apo regjistrimi i tyre si kandidatë për deputetë, i ardhur nga institucionet, për çdo ditë, në një periudhë që shtrihet nga data 25.03.2021, e cila përkon me datën e fillimit të fushatës zgjedhore dhe përfundon me datën 25.04.2021 dhe përbëhet nga 21 ditë pune.

Më poshtë, po analizojmë aspektet në të cilat është përqendruar puna e Komisionerit gjatë këtij procesi, për të arritur në një konkluzion të qartë në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë e nëpunësit civil gjatë kësaj fushate zgjedhore, si edhe të respektimit të të drejtave të tyre politike.

Ashtu si është evidentuar edhe më sipër, nëpërmjet grupeve të monitorimit, është raportuar çdo ditë pranë Sekretariatit të Komisionerit dhe në përfundim ka rezultuar se në këtë proces janë përfshirë **12896** nëpunës civilë, të cilët kryejnë funksionet e tyre në **200** institucione.

Fillimisht duhet të sqarojmë se statistikatat do të raportohen për mungesat e justifikuar me numër rastesh të justifikuar me aktet përkatëse që provojnë arsyen e mungesës (leje lindje, raport mjekësor, autorizim etj.) ndërsa për mungesat e pa justifikuar do të raportohen me ditë pune (21 ditë pune), çka do të thotë se për këto të fundit, mesatarja e shifrave do të gjendet duke i pjesëtuar me numrin e ditëve të punës në të cilat është shtrirë procesi.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelore rezultatet që kanë dalë nga përpunimi i të dhënave, duke specifikuar në tabelë, numrin e nëpunësve civilë të monitoruar, të ndarë sipas tipologjisë së institucioneve, mungesat me arsye dhe justifikimin e tyre, si dhe mungesat pa arsye.



**Tabela nr. 3** *Situata e prezencës në punë për periudhën e monitoruar, sipas raportimit të Grupeve të Monitorimit*

Institucionet e monitoruara	Mungesa të pa justifikuara	Mungesa të justifikuara		Totali i nëpunësve civilë
		Mungesa	Justifikimi	
<b>(1)</b> <b>Administrata Shtetërore</b>  <i>(Kryeministria Ministritë Institucionet e varësisë Prefekti i Qarkut)</i>  Total 114	33	3621	848- leje vjetore	6818
			444 - raporte mjekësore	
			124- leje lindje	
			1627- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit	
			4- pezullime	
			303- tele punë	
			203 – arsye personale, me leje nga eprori	
			68- trajnime profesionale	
<b>(2)</b> <b>Njësitë e QeverisjesVendore</b>  <i>(61 Bashki 12 Këshill Qarku)</i>  Total 73	27	1595	337- leje vjetore	5393
			247- raporte mjekësore	
			75- leje lindje	
			583- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit	
			1- pezullim	
			99- tele punë	
			162 – arsye personale, me leje nga eprori	
			91- trajnime profesionale	
<b>(3)</b> <b>Institucionet e Pavarura</b>  Total 13	3	396	53- leje vjetore	685
			72 - raporte mjekësore	
			12- leje lindje	
			164- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit	
			39- tele punë	
			43 – arsye personale, me leje nga eprori	
			13- trajnime profesionale	
			<b>(1 + 2 + 3)</b> <b>TOTAL</b>  200	
763 - raporte mjekësore				
211- leje lindje				
2374- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit				
5- pezullime				
441- tele punë				
408 – arsye personale, me leje nga eprori				
172- trajnime profesionale				

*a. Rastet e mos prezencës në punë, të justifikuara*

Nga analiza e të dhënave që janë pasqyruar më sipër, rezulton se janë raportuar gjithsej **5612** raste të mungesave të justifikuara për 21 ditë pune, për 12896 nëpunës civilë, nga të cilat, sipas llojit të justifikimit të paraqitur nga subjektet, rezulton se:

- ✓ në **1238** raste, mungesat janë për arsye të lejeve vjetore;
- ✓ në **763** raste, mungesat janë të justifikuara me raport mjekësor;
- ✓ në **211** raste, mungesat janë të justifikuara për shkak të lejes së lindjes;
- ✓ në **2374** raste, mungesat janë të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin për shërbime brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ në **172** raste, mungesat janë për shkak të përfshirjes së punonjësve në trajnime profesionale;
- ✓ në **408** raste, mungesat janë konstatuar të pjesshme gjatë ditës, për arsye pune jashtë institucionit, të justifikuara nga eprori, sipas natyrës së punës;
- ✓ në **441** raste, punë nga distanca për shkak të pandemisë COVID 19;
- ✓ në **5** raste, mungesat janë për shkak të pezullimit nga shërbimi civil;

Nga gjithë sa analizuam në këtë rast, Komisioneri vlerëson se kjo është një shifër normale, e cila justifikohet sidomos me faktin se muaji mars është muaji i fundit në të cilin mund të kryhen lejet vjetore të prapambetura, me procesin e trajnimit apo me funksionimin e institucioneve me natyrë auditimi dhe mbikëqyrjeje. Në këtë rast, Komisioneri është informuar nga grupet e monitorimit për arsyet e mungesave, duke dërguar edhe aktet e justifikimit të mungesave të raportuara.

*b. Rastet e mos prezencës në punë, të pajustificuara*

Nga ana tjetër, në lidhje me mungesat pa arsye, rezulton se nga grupet e monitorimit janë raportuar **63** raste të tilla dhe mesatarja ditore e të cilave (*21 ditë pune*) është **3 mungesa**, për **12896** nëpunës civilë. Ashtu si duket edhe nga të dhënat, kjo shifër paraqitet e papërfillshme edhe në normalitetin e punës së përditshme të administratës. Për më tepër, kjo shifër është ende duke u verifikuar nga ana e institucioneve, pasi në disa raste është konstatuar që mungesa ka qenë edhe e justifikuar, por për arsye të ndryshme nuk është pasqyruar drejt në aktin e konstatimit.

Megjithatë, Komisioneri ka kërkuar nga institucionet që edhe këto raste të verifikohen dhe nëse ndodhemi në kushtet e shkeljeve disiplinore, të ndiqen procedurat për marrjen e masave disiplinore.

Rezulton se problematikën më të theksuar në këtë kategori mungesash, e ka paraqitur institucioni i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë-Durrës-Dibër, ku rezulton se gjatë fushatës zgjedhore janë raportuar **32** raste të mungesave pa arsye.

Në këtë rast, Komisioneri ka kërkuar informacion pranë grupit të monitorimit, se çfarë qëndrimi është mbajtur për këta punonjës dhe ka rezultuar se ndaj tyre është marrë një masë administrative duke mos i paguar pagën për ditën e punës, në të cilën kanë munguar.

Për këtë rast, Komisioneri ka sjellë në vëmendje të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, se mungesa pa arsye në punë, në kuptim të nenit 57, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, përbën shkelje disiplinore, e cila në varësi të periudhës së mungesës, klasifikohet si:

- a) Shkelje e lehtë mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 ditë pune;
- b) Shkelje e rëndë – braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 3 ditë pune;
- c) Shkelje shumë e rëndë – braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 7 ditë pune.

Mos pagesa e ditës së punës, është një masë administrative, në aspektin financiar, e cila ndërmerret për shkak të mos paraqitjes në punë të nëpunësit, pa shkaqe të arsyeshme, por nga ana tjetër lind detyrimi i shqyrtimit të mungesës pa arsye, në kuadrin e shkeljes disiplinore.

Në këto rrethana, në zbatim të nenit 59, pika 2 dhe pika 4/b, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri ka orientuar institucionin që të fillojë ecurinë disiplinore nëpërmjet Komisionit Disiplinor pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë-Durrës-Dibër, për nëpunësin \*\*\*\*\* , pasi rezulton të ketë kryer 21 mungesa, të cilat përbëjnë shkelje shumë të rëndë disiplinore.

Po kështu, është orientuar institucioni që Komisioni Disiplinor duhet të fillojë ecurinë disiplinore për nëpunësin \*\*\*\*\* , i cili rezulton të ketë munguar në mënyrë të pajustificuar dhe të vijueshme për 3 ditë pune, e cila klasifikohet si shkelje e rëndë disiplinore.

Më tej, në zbatim të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është orientuar institucioni që eprori direkt i nëpunësve \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* , \*\*\*\*\* dhe për nëpunësin \*\*\*\*\* , duhet të shqyrtojë shkakun e mos prezencës së tyre në punë dhe në rast se do vlerësojë se ky fakt përbën shkelje disiplinore, në zbatim të nenit 59, pika 1, të po këtij ligji të fillojë ecurinë disiplinore ndaj tyre, pasi mungesat janë për më pak se 3 ditë pune.

Për të gjitha rastet e evidentuara më sipër, është kërkuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë-Durrës-Dibër që të njoftojë Komisionerin në lidhje me shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar dhe vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor, si dhe me masat e marra ndaj nëpunësve të cilët rezultojnë të kenë kryer mungesa individuale.

Komisioneri është duke e ndjekur në vijimësi këtë rast dhe do të informojë Kuvendin në vijim për ecurinë e procesit.

3. *Situata e konstatuar nga verifikimi në subjekt, nëpërmjet sondazheve ditore të grupeve të ngritura nga Komisioneri*

Nga të dhënat e administruara gjatë sondazheve që janë kryer në **45** subjekte, me një numër prej **1940** nëpunësish civilë, ku së bashku me grupin e monitorimit, gjatë hartimit të aktit të konstatimit në subjekt kanë qenë prezent edhe inspektorët e Komisionerit, situata është paraqitur si më poshtë:

**Tabela nr.4** *Situata e prezencës në punë gjatë monitorimit nga Komisioneri në subjekt*

Institucionet e monitoruara	Mungesa të pa justifikuara	Mungesa të justifikuara		Totali i nëpunësve civilë
		Mungesa	Justifikimi	
(1) <b>Administrata Shtetërore</b> <i>(Kryeministria Ministritë Institucionet e varësisë Prefekti i Qarkut)</i>	0	286	22- leje vjetore 18 - raporte mjekësore 23- leje lindje 61- rastet e kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit 141- tele punë 18 – arsyepersonale, me leje nga eprori	1256
Total 27			3- trajnimeprofesionale	
(2) Njësitë e QeverisjesVendore <i>(61 Bashki 12 Këshilla Qarku)</i>	0	120	9- leje vjetore 18 - raportemjekësore 11- lejelindje 55- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit 14- tele punë 12 – arsye personale, me leje nga eprori	471
Total 14			1- trajnime profesionale	
(3) Institucionet e Pavarura	0	82	16- leje vjetore 22- raporte mjekësore 4- leje lindje 19- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit 15 – arsye personale, me leje nga eprori	213
Total 4			6- trajnime profesionale	
(1 + 2 + 3) <b>TOTAL</b> <b>45</b>	<b>0</b>	<b>488</b>	47- leje vjetore 58- raporte mjekësore 38- leje lindje 135- raste të kushtëzuara nga natyra e punës, të justifikuara me autorizimin apo eprori, për lëvizje ditore jashtë institucionit 155- tele punë 45 – arsye personale, me leje nga eprori 10- trajnime profesionale	<b>1940</b>

Ashtu si duket nga kjo pasqyrë, **nuk është konstatuar asnjë rast i mungesave të pajustificuara dhe 488 raste të mungesave të justifikuara, në 1 ditë pune, për 1940 nëpunës civilë.**

Komisioneri ka treguar një kujdes të veçantë për të mbledhur të dhëna të hollësishme në lidhje me këtë proces monitorimi, të cilat i paraqiti të përmbledhura edhe në këtë raport, me qëllim që të diskutohet mbi fakte konkrete mbi sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës elektorale dhe jo mbi perceptime apo supozime.

**Në këto rrethana, sipas të dhënave të raportuara më sipër, si dhe duke u bazuar në të gjithë procesin e monitorimit të këtij aspekti, Komisioneri vlerëson se trupa e nëpunësve civilë, ka qenë në detyrë gjatë orarit zyrtar, duke ushtruar funksionet e saj ligjore, si dhe ka manifestuar pjekuri nëpërmjet respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil.**

Në lidhje me aspekte të vlerësuara me natyrën e shkeljeve disiplinore, në drejtim të mosrespektimit të disiplinës në punë, në rastin e mungesave të pajustificuara, ashtu si edhe u trajtua më sipër në disa raste konkrete, janë orientuar grupet e monitorimit që t'i hetojnë rast pas rasti dhe më tej, të kërkojnë fillimin e ecurisë disiplinore pranë organeve disiplinore, duke vlerësuar rëndësinë e shkeljes së konstatuar.

Në rastet me mungesa deri në 3 ditë, janë orientuar që kërkesa të paraqitet tek eprori direkt, pasi shkelja konsiderohet si e lehtë, sipas parashikimeve të nenit 57, të ligjit për nëpunësin civil, ndërsa për rastet e evidentuara me mungesa të pajustificuara të punonjësit mbi 3 ditë, janë orientuar që të paraqesin kërkesën pranë Komisionit të Disiplinës së institucionit, duke u konsideruar si shkelje të rënda e shumë të rënda disiplinore, sipas dispozitës së përmendur më sipër.

Ndërkohë, grupet e monitorimit janë orientuar që, në rast se gjatë hetimit rezulton se janë konsumuar elementët e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, nga ana e punonjësve që nuk janë paraqitur në punë pa leje, zgjidhja e çështjes t'i raportohet organeve të drejtësisë. Ky është një proces që ende po vijon, pasi Komisioneri i ka kërkuar institucioneve hetimin e të gjitha rasteve të konstatuara me mungesa pa arsye.

Në rastet e tjera, kur problematikat nuk kanë qenë të natyrës së shkeljeve disiplinore, të tilla kur është ometuar nënshkrimi, apo të rasteve kur nuk është materializuar justifikimi në regjistrin përkatës, ndërkohë që punonjësi ka qenë me leje ose në ushtrim të detyrës jashtë institucionit ato janë zgjidhur me këshillim nga ana e Sekretariatit të Komisionerit.

#### ***4. Respektimi i të drejtës për të marrë pjesë në zgjedhje me statusin e kandidatit për deputet, si dhe për të marrë pjesë në administratën zgjedhore***

Në lidhje me këtë aspekt, Komisioneri ka kërkuar dhe më tej, ka administruar të dhëna prej institucioneve, të cilat pasqyrojnë rastet kur nëpunësit civilë kanë kërkuar të jenë pjesë e

administratës zgjedhore, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve, si dhe GNV-ve; Operatorë ekonomikë dhe Trajnerë të administratës zgjedhore.

Për shkak të risive që solli procesi i votimit, duke sjellë për herë të parë rolin e Operatorit ekonomik, institucionet subjekte të procesit të monitorimit, janë udhëzuar të hartojnë aktet administrative për lejimin e ushtrimit të kësaj detyre, në kushtet kur kjo përbën një veprimtari me pagesë të kryer jashtë detyrës në shërbimin civil. Ky dokumentacion është kërkuar edhe për nëpunësit civilë, të cilët janë përzgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në cilësinë e Trajnerit për punonjësit e administratës zgjedhore.

Komisioneri e ka vlerësuar këtë pjesëmarrje si një veprimtari të jashtme të nëpunësit civil, pasi nuk përfshihet në detyrat e tij funksionale sipas përshkrimit të punës dhe nuk është një detyrim ligjor i parashikuar nga ndonjë ligj specifik. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 47, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet detyrimi i deklarimit të interesave dhe pasurisë, është kërkuar që kjo veprimtari të autorizohet me një akt të veçantë nga titullari i institucionit, ashtu si e parashikon kjo dispozitë ligjore.

Nga ana tjetër, Komisioneri, për të mbështetur punonjësit, si dhe në ndihmë të veprimtarisë zgjedhore të KQZ, i ka kërkuar institucioneve që të mos bëhen pengesë për të dhënë këto leje.

*Rezulton se në të gjitha rastet e pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në këto mekanizma, janë miratuar kërkesat e tyre dhe janë lëshuar autorizimet përkatëse.*

*Pranë Komisionerit nuk është paraqitur asnjë ankesë nga nëpunës civilë, si dhe nuk është dërguar ndonjë informacion tjetër nga KOZ apo çdo subjekt tjetër, që të tregojë se është mohuar e drejta e punonjësve, apo është penguar puna e KOZ-së në ndonjë rast.*

Po kështu, është monitoruar edhe respektimi i të drejtës së nëpunësit për të marrë pjesë në zgjedhje si kandidat për deputet, si edhe detyrimi i institucionit për të konstatuar kushtet e pezullimit të nëpunësit civil në këtë rast.

Kjo për faktin se, në zbatim të nenit 54/1/d, të ligjit për nëpunësin civil, ky rast parashikohet si një nga kushtet, kur njësia e burimeve njerëzore të institucionit ku është emëruar punonjësi, duhet të konstatojë pezullimin dhe të nxjerrë aktin përkatës që e pezullon nëpunësin nga detyra e tij.

Konkretisht, nga të dhënat që kanë arritur pranë Komisionerit, janë evidentuar **15** raste, kur nëpunës civilë janë regjistruar si kandidatë për deputetë dhe **680** raste, kur nëpunës civilë kanë marrë pjesë në administratën zgjedhore, nga të cilët, **159** raste, kur nëpunës civilë janë emëruar anëtarë të KZAZ-ve; **342** raste, kur nëpunës civilë, janë emëruar anëtarë të KQV-ve, dhe **164** raste, kur nëpunës civilë, janë emëruar si anëtarë të GNV-ve, të ndarë sipas tipologjisë së institucioneve në tabelën më poshtë:

**Tabela nr. 5** *Statistika në lidhje me pjesëmarrjen e nëpunësve civilë si kandidatë për deputetë si dhe në administratën zgjedhore*

Institucionet e Administratës Shtetërore	Kandidat për Deputet	Pjesëmarrja në administratën zgjedhore		
		KZAZ	KQV	GNV
Kryeministria dhe Ministrinë e Linjës Institucionet e varësisë Prefekti i Qarkut	8	90	71	69
<b>TOTAL</b>		<b>238</b>		

Institucionet e Qeverisjes Vendore	Kandidat për Deputet	Pjesëmarrja në administratën zgjedhore		
		KZAZ	KQV	GNV
Bashki Këshill Qarkut	7	68	269	95
<b>TOTAL</b>		<b>439</b>		

Institucionet e Pavarura	Kandidat për Deputet	Pjesëmarrja në administratën zgjedhore		
		KZAZ	KQV	GNV
<b>13</b>	0	1	2	0
<b>TOTAL</b>	<b>0</b>		<b>3</b>	

Ashtu si duket edhe në këtë pasqyrë të të dhënave, trupa e nëpunësve civilë ka dhënë një ndihmesë të rëndësishme në administrimin e procesit zgjedhor, duke rritur nivelin teknik të administratës zgjedhore, e për pasojë duke konsoliduar standardet e zgjedhjeve, drejt atyre më të mirave të hapësirës evropiane.

Realizimi i procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil, gjatë fushatës zgjedhore, krahas qëllimit për të siguruar parimin e paanësisë politike të shërbimit civil, është konceptuar nga ana e Komisionerit edhe si një mbështetje e njësive të administrimit të burimeve njerëzore, për të realizuar detyrat e tyre funksionale, që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për nëpunësin civil, të cilat shpesh paraqesin vështirësi edhe për shkak të natyrës së kontrollit që ato kanë, e për pasojë edhe të rezistencës së vazhdueshme që bëhet nga nëpunësit e të gjitha niveleve, për t'iu shmangur rregullave të qarta të disiplinës në punë, si dhe procedurave specifike që kërkohen të respektohen nga ligji i sipërcituar.

Vlerësojmë se, procesi i monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil, ka ndihmuar si: **a)** në drejtim të forcimit të disiplinës në punë të administratës publike; **b)** në drejtim të zbatimit të parimit të paañsisë politike në administrimin e shërbimit civil; po ashtu edhe **c)** në drejtim të fuqizimit të rolit të njësive të administrimit të burimeve njerëzore në këto institucione, të cilat janë konsideruar deri tani, jo në lartësinë e rëndësisë së detyrave të vështira funksionale që duhet të realizojnë sipas ligjit për nëpunësin civil, pasi shpesh ngarkohen me detyra të tjera, në ndihmë të veprimtarisë së njësive të tjera të strukturës së institucionit.

Komisioneri arrin në këtë përfundim, duke u nisur nga përmbajtja e akt-konstatimeve, në të cilat evidentohet një disiplinim i trupës së nëpunësve civilë, por edhe nga komunikimi me punonjësit e njësive të personelit, të cilët ndjehen të mbështetur, të vlerësuar dhe më të çliruar për të kryer detyrën e tyre funksionale, si nga eprorët e tyre, ashtu edhe nga nëpunësit civilë të institucionit. Nga ana e tyre raportohet se respektimi i disiplinës në punë është në nivele të larta, krahasuar kjo edhe me kohën e situatave normale, që nuk kanë të bëjnë me periudha zgjedhore.



## KAPITULLI V

### VERIFIKIMI I INFORMACIONIT TË MARRË NGA MEDIA DHE NGA DENONCIMET E QYTETARËVE

Një rëndësi të veçantë Komisioneri i ka kushtuar edhe verifikimit të informacioneve lidhur me pretendime për parregullsi në sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor.

Me qëllim që qytetarët të ishin sa më pranë institucionit dhe të denonconin raste të cilat i vlerësonin si sjellje në kundërshtim me ligjin të nëpunësve të administratës, në faqen zyrtare të Komisionerit në internet, krahas rubrikave ekzistuese që sigurojnë transparencën e institucionit në raport me qytetarët, u hap edhe një rubrikë tjetër e posaçme për të lehtësuar ndërveprimin me qytetarët.

Rezulton se në adresë të Komisionerit gjatë kësaj periudhe kanë ardhur disa denoncime të cilat do t'i analizojmë në vijim.

⇒ Në datën 16.04.2021, nëpërmjet një *e mail*-i në faqen zyrtare të institucionit, ka ardhur një denoncim anonim, në përmbajtje të të cilit pretendohet se disa punonjës të Bashkisë Çërrik (*janë listuar 10 emra qytetarësh*), kanë marrë pjesë në takime elektorale të subjekteve zgjedhore, brenda orarit zyrtar.

Në kushtet kur kryerja e veprimeve, apo sjelljeve që vijnë në kundërshtim me parimet bazë të sjelljes së nëpunësit civil, konsiderohet thyerje e rëndë e disiplinës në punë, nëpërmjet shkresës nr. 534/1 prot., datë 16.04.2021, "*Kërkesë, për marrjen e masave për verifikimin e menjëhershëm të rasteve të denoncuara*", Komisioneri kërkoi nga Grupi i Monitorimit të institucionit, verifikimin e menjëhershëm të rastit, duke evidentuar fillimisht faktin nëse qytetarët e listuar janë punonjës të institucionit dhe nëse pozicionet e punës përfshihen në kategorinë e nëpunësve civilë, e më tej, të referohet rasti pranë organeve të disiplinës.

Në vijim të komunikimit, Bashkia Çërrik, nëpërmjet shkresës nr. 1425/1, datë 23.04.2021, "*Informacion*", ka njoftuar Komisionerin se, 10 rastet e denoncuara, janë punonjës të këtij institucioni, nga të cilët 8 prej tyre janë nëpunës civilë, ndërsa në 2 raste bëhet fjalë për punonjës të emëruar në pozicione pune jashtë shërbimi civil.

Në këtë rast, Grupi i Monitorimit në Bashkinë Çërrik, ka informuar Komisionerin nëpërmjet postës elektronike (*e-mail*), se janë evidentuar veprime të nëpunësve civilë në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar. Në pikën 1 të këtij neni parashikohet se: "*Nëpunësi civil ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike jashtë orarit zyrtar dhe nuk duhet të shprehë hapur bindjet apo preferencat e tij politike*".

Për vlerësimin e shkeljeve të ndodhura, sipas kërkesave të Kreut X, "*Disiplina*", të ligjit për nëpunësin civil, me urdhrin nr. 57/1, datë 18.05.2021, të Kryetarit të Bashkisë Çërrik, është

ngritur Komisioni Disiplinor pranë këtij institucioni, i cili pasi e ka vlerësuar situatën, veprimet e punonjësve i ka cilësuar në kategorinë e shkeljeve të lehta dhe aktet i janë dërguar për veprim prororit direkt, që është organi disiplinor kompetent për shqyrtimin e tyre.

Pas zhvillimit të procedurave, rezulton se për 8 punonjësit e Bashkisë Cërrik është marrë masa disiplinore "Vërejtje", e cila është në fuqi dhe e përfshirë në dosjen e personelit të nëpunësit dhe nuk është ankimuar prej tyre.

⇒ Përmes shkresës me nr. 1725/1 prot., datë 12.05.2021, të Drejtorit Rajonal, të institucionit Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier-Vlorë-Gjirokastër, ka ardhur një denoncim, në përmbajtje të së cilit parashtrohet se, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore është konstatuar që nëpunësi \*\*\*\*\*, me detyrë "Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit", pranë këtij institucioni, ka shprehur publikisht hapur bindjen e tij politike për një subjekt politik të caktuar.

Konkretisht, në përmbajtje të këtij informacioni thuhet se, në adresë të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier-Vlorë-Gjirokastër, kanë ardhur denoncime ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*, duke pretenduar se ky nëpunës nëpërmjet rrjetit social "Facebook", ka shprehur hapur bindjet dhe preferencat e tij politike gjatë periudhës së monitorimit të fushatës zgjedhore.

Rezulton se, Grupi i Monitorimit i ngritur në këtë institucion, me urdhrin nr. 3, datë 24.02.2021, të Drejtorit Rajonal, pas marrjes dijeni të këtyre pretendimeve, ka kryer verifikimet në rrjetin social "Facebook" dhe nëpërmjet shkresës nr. 1725 prot., datë 11.05.2021, ka informuar titullarin e institucionit se adresa në rrjetin social "Facebook", i përket nëpunësit \*\*\*\*\*, duke i vënë në dispozicion foto, të cilat justifikojnë pretendimet e ngritura në adresë të këtij nëpunësi.

Komisioneri, me shkresën nr. 458 prot., datë 05.04.2021, ka sqaruar të gjitha institucionet të cilat punësojnë nëpunës civilë, se përdorimi i rrjeteve sociale, i platformave sociale apo mjeteve të tjera të komunikimit elektronik për qëllime të propagandimit apo shprehjes publike të bindjeve dhe preferencave politike përbën një veprim që vjen në kundërshtim me përcaktimet e nenit 37, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për evidentimin e këtyre rasteve, Komisioneri ka kërkuar që grupet e monitorimit të tregojnë kujdes të posaçëm, sidomos në drejtim të saktësisimit të faktit, nëse subjekti i denoncuar është i njëjti person me përdoruesin e llogarisë në rrjet.

Në analizë të dokumentacionit të dërguar për rastin konkret, konstatohet se nëpunësi \*\*\*\*\* ka komentuar në fotot e shpërndara nga një subjekt politik dhe se komentet janë kryer gjatë periudhës së fushatës zgjedhore për Kuvendin e Shqipërisë 2021. Nga ana tjetër, në materialin bashkëlidhur këtij informacioni janë dërguar foto, të shpërndara nga ky nëpunës në rrjetin e tij social "Facebook" në periudha të mëparshme, me qëllim për të vërtetuar përkatësinë e kësaj adrese në emër të nëpunësit \*\*\*\*\* (ku mund të përmendim foto të publikuara në vitin 2017 apo 2020).

Në këtë vlerësim të fakteve të paraqitura, Komisioneri çmoi se, Grupi i Monitorimit dhe Drejtori Rajonal i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier-Vlorë-Gjirokastrë, në rolin e eprorit direkt, janë organet kompetente disiplinore për të vlerësuar nivelin e shkeljes në komentet e kryera nga nëpunësi \*\*\*\*\* në rrjetin social "Facebook", kjo në kuptim të pikës 4, germa "ç" dhe të nenit 57, pika 3, germa "dh"/ të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Në përfundim të këtij vlerësimi do të vendoset nëse çështja do të trajtohet nga eprori direkt në rastin e shkeljeve të lehta, apo do të përcillet pranë Komisionit të Disiplinës, nëse vlerësohen si shkelje të rënda ose shumë të rënda.

Komisioneri është në ndjekje të këtij rasti dhe ka kërkuar nga institucioni që në përfundim të trajtimit të tij, të njoftohet në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të denoncimeve të ardhura për nëpunësin \*\*\*\*\*.

⇒ Nëpërmjet kërkesës së paraqitur nga disa nëpunës të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, protokolluar pranë Komisionerit me nr. 49, datë 12.01.2021, dhe nr. 68, dt. 18.01.2021, është ngritur pretendimi se në institucionin në fjalë, janë ndërmarrë veprime administrative për ristrukturimin e institucionit, të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve, prej dokumentacionit të mbledhur për këtë qëllim nga ana e Komisionerit, rezulton se institucioni i Autoritetit të Aviacionit Civil, në zbatim të Urdhrit nr. 359, datë 18.12.2020, të Kryeministrit, ka nisur procesin e ristrukturimit, për të cilin pretendohet se ai nuk duhet të kryhet, për shkak të ndalimit të urdhëruar prej Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Nga analiza e germës d), të pikës 1/1.3, të nenit 3, të Kreut II, të vendimit në fjalë, janë të ndaluara këto procese: "Marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja, dhe transferimi në detyrë në institucionet, apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përlijtura...etj."

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimit të kryer nga institucioni në këtë rast, si dhe për të qartësuar pretendimin mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, Kreu III "Procedura paraprake", të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, u krye verifikimi i çështjes prej nga rezultoi se, me miratimin e ligjit nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë", ka lindur nevoja për ngritjen apo përshtatjen e njëjësive strukturore të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, në shërbim të realizimit të detyrimeve të reja që rrjedhin nga ky ligj, dhe për riorganizimin e natyrës së shërbimeve, e shoqëruar kjo edhe me disa ndryshime në strukturën organizative të institucionit.

Këto ndryshime të kërkuara nga ligji në fjalë, kanë gjetur materializim në Urdhër nr. 359, datë 18.12.2020, të Kryeministrit, "Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil". Mbi këtë bazë, për të kryer implementimin e strukturës së re, me Urdhër nr. 8, datë 14.01.2021, të Departamentit të Administratës Publike, "Për krijimin e Komisionit

*të Ristrukturimit, në kuadër të ristrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil”, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, i cili filloi menjëherë punën në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të DAP, “Për krijimin funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”, të ndryshuar.*

Komisioni i Ristrukturimit, ka konstatuar se organika e miratuar me Urdhrin nr. 359, datë 18.12.2020, të Kryeministrit, “Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil”, ka në përbërje 79 pozicione pune, nga të cilat 69 pozicione të shërbimit civil dhe 10 pozicione me marrëdhënie kontraktore në bazë të Kodit të Punës, ndërkohë që organika e mëparshme (e miratuar me Urdhrin nr. 2, datë 11.01.2019 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil”) kishte në përbërje 73 pozicione, prej të cilave 65 pozicione të shërbimit civil dhe 8 pozicione me kontratë.

Pra, në përgjithësi struktura e fundit, ka vetëm shtesa në organikë dhe se pozicionet aktuale të punës, nuk preken nga ristrukturimi, kështu që nuk parashikohet të krijohet ndonjë situatë administrative që të vijë në kundërshtim me kërkesat e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Gjithashtu ky Komision, si dhe të gjithë aktorët e tjerë pjesëmarrës në këtë proces, kanë konsultuar Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, me kapital shtetëror agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarive, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, në lidhje me vijueshmërinë e procesit që janë duke kryer dhe kanë marrë këshillimet e nevojshme.

Duke analizuar gjendjen e fakteve si më sipër, e duke bërë krahasimin e nevojshëm ndërmjet dispozitave të ndryshme konkurruese në zhvillimin e këtij procesi, Komisioneri në këtë rast ka evidentuar për të theksuar momentet e mëposhtme:

*Së pari*, meqenëse nuk ka reduktime të pozicioneve të mëparshme të punës, por ka vetëm një shtesë në organikë prej 6 pozicioneve të reja pune, duket i arsyeshëm qëndrimi i njësisë së burimeve njerëzore të institucionit që argumenton se, duke u bazuar dhe në konkluzionet e Komisionit të Ristrukturimit, stafi aktual do të vijojë të jetë pjesë e institucionit, sipas kategorive përkatëse që mbanin aktualisht secili prej tyre.

Kjo do të thotë që në thelbin e tij, nga pikëpamja materiale, implementimi i strukturës së re nuk shoqërohet me cenime të drejtave të punësimit të punonjësve të mëparshëm të institucionit, gjë e cila në të kundërtën, do të diktonte një gjendje që binte ndesh me përmbajtjen e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e që mund të interpretohej se po kryhej me qëllim favorizimi të personave apo subjekteve të ndryshme politike, në fushatën elektorale që pritet të zhvillohet.

*Së dyti, sipas përcaktimit të germës d), të pikës 1/1.3, të nenit 3, të kreut II, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë të ndaluara 4 muaj para zgjedhjeve: “Marrja në punë, pushimi nga puna lirimi, lëvizja, dhe transferimi në detyrë në institucionet, apo entet publike, shtesat në organikën e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërimet provizore në përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi, përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik nëpër mbushjet e misionit të tij”.*

Nisur nga përmbajtja e dispozitës së cituar më sipër, konstatohet se, në rastin konkret jemi para një *“rasti të përligjur”*, pasi struktura që është duke u implementuar në institucionin Autoriteti i Aviacionit Civil, është miratuar me Urdhrin nr. 359, datë 18.12.2020, të Kryeministrit, *“Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil”*, i cili në kuptimin e veprimit të normës juridike në kohë, ka hyrë në fuqi përpara se të miratohej Vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kjo do të thotë se në këtë rast, veprimet administrative që po kryhen nga Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse, janë të ligjshme jo vetëm se po kryhen përpara fushatës zgjedhore, ashtu si e kërkon dispozita e cituar (*fushata zgjedhore në kuptim të nenit 77 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, fillon 30 ditë para datës së zgjedhjeve dhe përfundon 24 orë para datës së zgjedhjeve*), por në këtë rast jemi në zbatim të një akti të ligjshëm i cili ka dalë para daljes së Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të hetimit dhe gjetjeve të citura si më lart, Komisioneri vlerësoi se, procesi i ristrukturimit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nga pikëpamja ligjore, po kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i shërbimit civil dhe me urdhërimet e Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, prandaj vendosi për përfundimin e hetimit administrativ dhe arkivimin e rastit.

## KAPITULLI VI

### ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT CIVIL NË LIDHJE ME DISA INSTITUTE TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL TË APLIKUARA GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

#### **1. Pezullimi nga shërbimi civil për shkak të ligjit, pasi nëpunësi civil është regjistruar si kandidat për zgjedhjet politike**

Në vijim të procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, si dhe duke pasur në vëmendje rregullimet e Kodit Zgjedhor dhe në mënyrë specifike përcaktimet e nenit 6, pika 1, 2 dhe 7, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga institucionet e administratës shtetërore, të vetëqeverisjes vendore si dhe institucionet e pavarura, është kërkuar informacion në lidhje me rastet e pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në administratën zgjedhore, apo të regjistruar si kandidatë për deputet.

Në zbatim të nenit 37 dhe 47, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të gjithë Grupet e Monitorimit të ngritura në institucionet e administratës publike, përmes komunikimit elektronik, kanë dërguar pranë Komisionerit aktet administrative të cilat materializojnë procesin e miratimit të kërkesës së nëpunësve civilë për të ushtruar funksione të administratës zgjedhore.

Nga ana tjetër, për nëpunësit civilë të cilët kanë ushtruar të drejtën e kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, Komisioneri ka kërkuar nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucioneve respektive, konstatimin e arsyes së pezullimit nga shërbimi civil, që në këtë rast është për shkak të parashikimeve në nenin 37, pika 3 dhe nenin 54, pika 1, germa d), të ligjit për nëpunësin civil.

Në referencë të informacionit të administruar gjatë këtij procesi, në **15** raste, nëpunësit që kanë qenë kandidatë për deputetë, janë pezulluar nga shërbimi civil për periudhën e përcaktuar në ligj dhe aktet që e provojnë këtë fakt i janë dërguar Komisionerit.

Gjithashtu, gjatë periudhës së monitorimit të fushatës zgjedhore ka pasur edhe raste pezullimi nga shërbimi civil, për arsye të ndryshme me kërkesë të vetë nëpunësit civil. Janë evidentuar **6** raste të tilla ku arsyet lidhen: me punësimin në një institucion që nuk është pjesë e shërbimit civil; me ndjekjen e studimeve të programit doktoraturë; punësimi në institucione ndërkombëtare, etj. Aktet që materializojnë këtë procedurë i janë dërguar Komisionerit.

Pra, nga sa u parashtrua më sipër, rezulton se gjatë aplikimit të institutit të pezullimit nga shërbimi civil, është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit.

#### **2. Emërimet në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, për periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore**

Gjatë mbikëqyrjes së ushtruar nga Komisioneri në institucionet e administratës publike, u kërkua në mënyrë të vazhdueshme informacion për situatën e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, për periudhën e procesit zgjedhor 25 mars - 25 prill, të shoqëruar me aktet përkatëse të emërimit, me qëllim evidentimin e tyre dhe

marrjen e masave për paralajmërimin e institucioneve, me qëllim ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë.

Në përfundim të përpunimit të informacionit të dërguar, rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer **14** emërimë në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, që i përkasin **1** rast një institucioni në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe **13** raste i përkasin institucioneve të vetëqeverisjes vendore (*Bashki dhe Këshilla Qarku*).

Më poshtë janë evidentuar punonjësit e emëruar dhe institucionet që kanë vepruar në kundërshtim me ligjin:

- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, institucion në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

Punonjësja \*\*\*\*\* , është emëruar në pozicionin e punës “*Specialist, Arkiv/Protokoll/Burimet Njerëzore*”, në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, me Urdhrin nr. 13, datë 08.04.2021, “*Për emërimin në detyrë*”, të Drejtorit të Përgjithshëm, duke mos respektuar procedurën e pranimit në shërbimin civil. Punonjësja është emëruar përkohësisht, për shkak të largimit me leje lindje të nëpunëses që mbante këtë detyrë më parë. Në një rast të tillë, sipas parashikimeve ligjore, emërimi për nevoja pune, për një periudhë të caktuar, kryhet nga punonjës që janë brenda sistemit të shërbimit civil.

- Institucionet e vetëqeverisjes vendore, ku janë evidentuar **13** raste, për këta punonjës:
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist i Integritimit me BE*”, në Bashkinë Kurbin, me Urdhrin nr. 96, datë 25.03.2021, “*Për komandim të përkohshëm në detyrë dhe lidhje kontrate individuale*”, të Kryetarit të Bashkisë.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist i emergjencave civile*”, në Bashkinë Kurbin, me Urdhrin nr. 95, datë 25.03.2021, “*Për komandim të përkohshëm në detyrë dhe lidhje kontrate individuale*”, të Kryetarit të Bashkisë.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist për Integrimin, monitorimin dhe raportimin*”, Sektori i Projekteve, Integritimit Europian dhe Marredhënieve me Diasporën, në Bashkinë Devoll, me Urdhrin nr. 142, datë 25.03.2021, “*Për emërimin e përkohshëm të detyrës*”, të Kryetarit të Bashkisë.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës Sektori*”, Sektori i Bujqësisë dhe Trajtimit të Titujve të Pronësisë, në Bashkinë Pogradec, me Urdhrin nr. 208, datë 06.04.2021, “*Për shkarkimin dhe emërimin e përkohshëm të znj. Dalina Çami*”, të Kryetarit të Bashkisë.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Shef i Sektorit të Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar*”, në Bashkinë Libohovë, me Urdhërin nr. 31, datë 09.04.2021, “*Për emërim të përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Bashkisë.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Zhvillimit Rajonal*”, në Këshillin e Qarkut Gjirokastër, me Urdhërin nr. 36, datë 09.04.2021, “*Për emërim të përkohshëm në detyrë*”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist i Çështjeve Sociale dhe Arsimit*”, në Këshillin e Qarkut Kukës, me Urdhrin nr. 25, datë 06.04.2021, “*Për emërim në detyrë*”, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut.
  - \*\*\*\*\* , emëruar në pozicionin e punës “*Specialist për Inspektimin Tatimor*”, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, në Bashkinë Fier, me Urdhrin nr. 123, datë 30.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.

- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialist i planifikimit dhe zhvillimit të territorit*”, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në Bashkinë Divjakë, me Urdhrin nr. 100, datë 13.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialist pyjesh dhe zonave të mbrojtura*”, Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, në Bashkinë Mallakastër, me Urdhrin nr. 96, datë 09.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialiste e zyrës me një ndalesë*”, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Mallakastër, me Urdhrin nr. 91, datë 02.04.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialist transporti, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse*”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Bashkinë Mallakastër, me Urdhrin nr.83, datë 25.03.2021, të Kryetarit të Bashkisë.
- \*\*\*\*\*, emëruar në pozicionin e punës “*Specialist Projektsh*”, në Bashkinë Malësi e Madhe, me Urdhrin nr.73, datë 19.04.2021, “*Për emërimin e përkohshëm*”, të Kryetarit të Bashkisë.

Aktet e emërimit të evidentuara më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në bazë të nenit 22, 23, 25 dhe 26 të tij, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. *Çdo emërim që bëhet në kundërshtim me këtë rregull, është absolutisht i pavlefshëm.*

Në vijim të këtij arsyetimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*”, veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë.

Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit në fjalë, vetë organi publik, në këtë rast titullari i institucionit, duhet të konstatojë ekzistencën e rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit dhe të rregullojë pasojat duke ndërprerë marrëdhënien e punës të lidhur në kundërshtim me procedurat ligjore.

Rregullimi i ligjshmërisë në këtë rast është duke u ndjekur nëpërmjet vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, sipas procedurave të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil dhe në rregulloren e brendshme të procedurave. Për ecurinë e këtij procesi, në vijim Komisioneri do të informojë në kohë reale Kuvendin.

### ***3. Rastet e emërimeve në shërbimin civil, në zbatim të legjisllacionit të shërbimit civil, për periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore***

Në përfundim të analizës së të dhënave të administruara nga institucionet e monitoruara, në periudhën e fushatës zgjedhore, rezultojnë se në total janë kryer **89** emërime në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **82** emërime janë kryer nëpërmjet konkurrimit, të cilat sipas institucioneve të monitoruara dhe procedurës së zhvilluar, paraqiten në tabelën në vijim:



**Tabela nr.6** *Pasqyrimi i emërimeve në shërbimin civil në përputhje me ligjin*

Emërimet në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil					
INSTITUCIONET	Pranim në shërbimin civil	Lëvizje paralele	Ngritje në detyrë	Rikthim në detyrë i nëpunësve civilë gjyqfitues, neni 66/1	Emërim i studentëve të ekselencës
Administrata Shtetërore	36	11	2	4	3
Njësitë e Vetëqeverisjes vendore	10	0	10	0	0
Institucionet e pavarura	12	1	0	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>58</b>	<b>12</b>	<b>12</b>	<b>4</b>	<b>3</b>

Sipas të dhënave të pasqyruar në tabelë, rezulton se për këtë periudhë monitorimi emërimet e reja në shërbimin civil, paraqiten sipas kategorive në vijim:

- **36** pranime në shërbimin civil në institucionet e administratës shtetërore; **10** pranime në institucionet e vetëqeverisjes vendore; dhe **12** pranime në institucionet e pavarura;
- **11** lëvizje paralele në institucionet e administratës shtetërore; **1** lëvizje paralele në institucionet e pavarura;
- **12** procedura konkurrimi për ngritje në detyrë; nga të cilat **2** ngritje në detyrë në institucionet e administratës shtetërore dhe **10** ngritje në detyrë në institucionet e vetëqeverisjes vendore;
- **4** rikthim në detyrë për shkak të ekzekutimit të vendimit gjyqësor;
- **3** raste të emërimit të studentëve të ekselencës.

Duke analizuar mënyrën e plotësimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil, Komisioneri arrin në konkluzionin se:

- Emërimet e kryera në përfundim të procedurave të konkurrimit (82 raste) janë realizuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit që rregullon këtë aspekt të shërbimit civil. Ajo çka vlen të theksohet në këtë rast, është se, këto procedura nuk përbëjnë veprimtari të ndaluar në kuptim të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të KQZ-së, pasi janë kryer në përputhje me planin vjetor të rekrutimit të miratuar në secilin institucion, si dhe për pozicione që janë pjesë e strukturës funksionale të institucionit.
- Emërimet e studentëve të ekselencës (3 raste), janë kryer në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 586, datë 30.08.2019, “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore”, faza e tretë.

- Rikthimi në detyrë i nëpunësve civilë gjyqfitues (4 raste), është kryer në përputhje me nenin 66/1, të ligjit për nëpunësin civil.

#### 4. ***Rastet e përfundimit të marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, gjatë periudhës së monitorimit***

Nga të dhënat e dërguara nga Grupet e Monitorimit, të ngritura pranë secilit institucion, për rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, rezulton se, për periudhën e monitorimit të fushatës zgjedhore, janë konstatuar raste të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak:

- ✓ Dorëheqje në **20** raste të ndara: **8** raste në institucionet e administratës shtetërore; **9** raste në institucionet e vetëqeverisjes vendore; dhe **3** raste në institucionet e pavarura;
- ✓ Për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë, neni 65, germa d), në **2** raste në administratën shtetërore. Bëhet fjalë për, **2** punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- ✓ Për **1** rast largimi nga shërbimi civil, si masë disiplinore dhënë për një punonjës, në Agjensinë Kombëtare të Mjedisit.
- ✓ Dalje në pension të plotë pleqërie në **5** raste të ndara: **1** rast në institucionet e administratës shtetërore; **2** raste në institucionet e vetëqeverisjes vendore; dhe **2** raste në institucionet e pavarura. Këto raste janë në zbatim të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit për ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit për punonjësit të cilët kanë mbushur moshën për dalje në pension të plotë pleqërie.

***Tabela nr.7 Përfundim i marrëdhënies në shërbimin civil***

<b>INSTITUCIONET</b>	<b><i>Dorëheqje nga detyra neni 64</i></b>	<b><i>Për shkak të dënimit me vendim të formës së prerë nga gjykata neni 65, germa d)</i></b>	<b><i>Largim nga shërbimi civil, si masë disiplinore</i></b>	<b><i>Pension i plotë pleqërie neni 65, germa c)</i></b>
Administratë Shtetërore	8	2	1	1
Vetëqeverisje vendore	9	0	0	2
Institucionet e pavarura	3	0	0	2
<b>TOTAL</b>	<b>20</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>5</b>

Situata e evidentuar më sipër, ku lirimi nga shërbimi civil është kryer për raste të parashikuara nga ligji dhe kur konstatohet vetëm një rast i largimit nga shërbimi civil nëpërmjet masës disiplinore, vlerësohet pozitivisht nga Komisioneri, sepse tregon për respektimin e parimeve të administrimit të shërbimit civil, sidomos atij të paanësisë politike dhe të qëndrueshmërisë së shërbimit civil.

## 5. *Aplikimi i institutit të transferimit në shërbimin civil, gjatë periudhës së monitorimit*

Ky institut i ligjit ka gjetur zbatim në **7** raste, të ndara sipas institucioneve:

- ✓ **1** rast transferimi i përhershëm në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për shkak të ristrukturimit të institucionit, që ka nisur para vitit 2021.
- ✓ **6** raste transferimi të përkohshëm për shkak të nevojave të punës, të kryera në **5** raste në institucionet e administratës shtetërore, (*Agjensia Kombëtare e Bregdetit ; Agjensia Kombëtare e Pyjeve; Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit; dhe 2 raste Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve*) dhe 1 rast në institucionin e vetëqeverisjes vendore Bashkia Kukës.

Ndërkohë, në institucionin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës janë rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, pas përfundimit të periudhës së transferimit **4** punonjës, sipas vendimeve të njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, çka është një detyrim ligjor në këtë rast.

*Tabela nr.8      Transferime gjatë periudhës së monitorimit*

INSTITUCIONET	Transferim i përhershëm	Transferim i përkohshëm	Rikthim në pozicionin e punës pas përmbylljes së periudhës së transferimit
Administratë Shtetërore	1	5	4
Vetëqeverisjes vendore	0	1	0
Institucionet e pavarura	0	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>4</b>

Nga sa u analizua më sipër, rezulton se procedurat e transferimit janë kryer në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj.

## 6. *Kallëzimet penale*

Nga informacionet e marra nga subjektet me të cilat Komisioneri ka bashkëpunuar në këtë proces, rezulton se në **2** raste është regjistruar kallëzim penal me subjekt nëpunës civilë, nga të cilët në **1** rast, punonjësi është pjesë e institucioneve të vetëqeverisjes vendore dhe **1** rast punonjës institucioni varësie.

- Konkretisht, nëpërmjet informacionit të shkëmbyer me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri ka rënë në dijeni të faktit se, në institucionin e Bashkisë Bulqizë, punonjësi \*\*\*\*\* me detyrë "*Përgjegjës i Sektorit Juridik*", pranë këtij institucioni, është ndaluar nga autoritet e Policisë dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, pasi dyshohet se ka konsumuar elementë të veprës penale të shitblerjes së votës.

Duke e vlerësuar rëndësinë e fenomenit si dhe me qëllim që të mundësohej mbikëqyrja e zbatimit të parimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Komisioneri ka kërkuar informacion në lidhje me këtë rast nga institucioni, si edhe të njoftohet për vijimësinë e procesit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga institucionet e specializuara që do të hetojnë dhe gjykojnë çështjen.

Komunikimi me institucionin e Bashkisë Bulqizë, u realizua përmes postës elektronike e-mail zyrtar dhe nga ana e institucionit u përcoll informacioni se, nëpunësi \*\*\*\*\*, gjendet në burgun e Burrelit, pasi dyshohet për kryerjen e veprës penale të shitblerjes të votës, si rrjedhim çështja e tij është nën hetim nga organet ligjzbatuese. Sipas sqarimit të dhënë nga institucioni, në lidhje me këtë rast, ata nuk janë njoftuar zyrtarisht nga ana e Policisë së Shtetit, por duke e marrë të mirëqenë njoftimin e dhënë në mediat vizive. Me Urdhrin nr. 105, datë 23.04.2021, “Pezullim nga detyra”, të njësisë përgjegjëse në Bashkinë Bulqizë, është vendosur pezullimi i këtij nëpunësi nga detyra, deri në marrjen e vendimit nga organet kompetente.

- Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioneri, në lidhje me denoncimet e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, është rënë në dijeni të faktit në institucionin Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Korçë, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, ka pasur kallzim për një nëpunës, i cili dyshohet se ka abuzuar me shpërndarjen e naftës për fermerët e zonës. Rasti është duke u hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, si dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Ky proces i nisur, do të ndiqet me një vëmendje të veçantë nga Komisioneri dhe në përfundim të çështjes nga ana e Prokurorisë, apo më tej të Gjykatës, sipas vendimmarrjes së këtyre institucioneve kompetente, do të udhëzohen institucionet se si duhet të veprojnë në vijim.

## KAPITULLI VII

### KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- Komisioneri vlerëson se gjatë këtij procesi zgjedhor, baza ligjore e monitorimit të sjelljes së nëpunësit civil ka qenë e plotë dhe e qartë, duke marrë parasysh ndryshimet e Kodit Zgjedhor, si edhe rregullat e vendosura në vendimin nr.9/2020, të KQZ, edhe kërkesat e Komisionerit të evidentuara në përmbajtjen e raporteve të monitorimit në rastin e zgjedhjeve të realizuara në vitin 2017 dhe 2019, përfshirë këtu, ndër të tjera edhe përcaktimin në mënyrë të shprehur të veprimtarive të ndaluara gjatë fushatës zgjedhore.
- Rregullat e vendosura nga KQZ, për veprimtarinë e nëpunësve të administratës, ku përfshihen edhe nëpunësit civilë, kanë qenë në përputhje të plotë me ligjin për nëpunësin civil dhe kanë qartësuar subjektet për të dalluar qartë llojin e shkeljes disiplinore.
- Është konstatuar paqartësi nga ana e institucioneve për të vlerësuar sjelljen e nëpunësve civilë në rrjetet sociale, çka u pasua nga një udhëzim i Komisionerit, ku kërkohej vetpërmbajtje e nëpunësve gjatë postimit në rrjetet sociale në lidhje me shprehjen e bindjeve politike apo mbështetjen e një subjekti të caktuar zgjedhor dhe nga ana tjetër përgjegjësi disiplinore në rastet kur nuk respektohej ky kriter.
- Sipas raportimit të Grupeve të Monitorimit, të ngritura në institucionet që punësojnë nëpunës civilë, ashtu edhe nga sondazhet e zhvilluara në subjekte nga Komisioneri, konstatohet në përgjithësi një sjellje korrekte e nëpunësve civilë, të cilët kanë respektuar parimet, kërkesat dhe procedurat e kërkuara nga ligji për nëpunësin civil.
- Njësitë e burimeve njerëzore duhet të kujdesen që të sigurojnë një disiplinë korrekte edhe në situatën normale, pas zgjedhjeve.
- Në rastin e aplikimit të institutit të pezullimit, për shkak të pjesëmarrjes si kandidat për deputet, në këto zgjedhje politike, nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi civil është i emëruar, vlerësojmë se është respektuar kërkesa ligjore, për konstatimin e pezullimit të statusit të nëpunësit civil, për shkak të pjesëmarrjes si kandidat në këto zgjedhje.
- Për periudhën e monitorimit, janë konstatuar raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, duke mos respektuar procedurën e konkurrimit.
- Janë konstatuar raste të veprimeve të punonjësve në kundërshtim me ligjin, edhe pse në raste të veçara.
- Në rastin e veprimtarive të jashtme të nëpunësve civilë, Komisioneri ka konstatuar se nga ana e titullarit të institucionit, pas kërkesës së nëpunësit civil, është zbatuar kërkesa ligjore, për të lejuar këto kategori veprimtarish, të tilla si, pjesëmarrje në administratën zgjedhore, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, Trajner i KQZ, apo Operatorëve Teknikë, duke lëshuar edhe autorizimin përkatës.

- Komisioneri vlerëson se Grupet e Monitorimit kanë zhvilluar me korrektesë verifikimin e rasteve të denoncuara dhe më tej, kanë vijuar procedurën ligjore për ndjekjen e rasteve kur janë konstatuar shkelje disiplinore.
- Komisioneri është duke e ndjekur ecurinë e kallëzimeve penale që janë depozituar pranë Prokurorisë, në ngarkim të nëpunësve civilë, me pretendimin se kanë cenuar procesin zgjedhor, për të vlerësuar më tej objektivitetin dhe efikasitetin e tyre.
- Duke vlerësuar ecurinë e procesit të monitorimit dhe impaktin që ai pati në disiplinimin e administratës, Komisioneri vlerëson se ky proces duhet të vijojë edhe në rastet e proceseve zgjedhore në të ardhmen.
- Njësitë e administrimit të burimeve njerëzore duhet të vijojnë komunikimin me Komisionerin, pas kësaj eksperience të suksesshme bashkëpunimi, për të rritur nivelin e zbatimit të ligjit për nëpunësit civilë, në të gjitha aspektet e tij.
- Të mbështeten njësitë e burimeve njerëzore nga titullarët e institucioneve, si me personel, ashtu edhe duke vlerësuar rolin e tyre në administrimin e shërbimit civil.
- Komisioneri vlerëson se, duke vepruar në mbështetje të një procesi zgjedhor në përputhje me ligjin, ka ndihmuar për të siguruar një proces më të mirë zgjedhor në vendin tonë, drejt standardeve më të mira të Hapësirës Evropiane.
- Komisioneri i kërkon institucioneve të përmendura në këtë raport për problematika konkrete që të ndjekin rekomandimet e Komisionerit dhe të raportojnë për ecurinë e procesit.
- Në përfundim, Komisioneri vlerëson se institucionet reagojnë menjëherë për të plotësuar kërkesat e procesit të monitorimit duke ndihmuar kështu, që shërbimi civil të ngrihet në një nivel tjetër, më të lartë, drejt standardeve më të mira Evropiane.
- Nëpunësit civilë, të ndërgjegjshëm për detyrën e rëndësishme që kanë në piramidën e shtetit, duhet të jenë pararoja e reformimit rrënjësor të mentalitetit të administratës në vendin tonë, drejt jetësisimit të parimeve të tilla, si parimi i përgjegjshmërisë në punë, paanësisë politike dhe meritokracisë.
- Komisioneri i drejton vlerësimet më të mira nëpunësve civilë, që në këtë proces zgjedhor, të përgatitur për sfidat me të cilat do t'i përballë integrimi i vendit në BE, kanë ndryshuar rrënjësisht sjellje, në kahun e zbatimit të ligjit dhe të realizimit të rolit të tyre në zhvillimin e vendit.
- Nëpunësit civilë mirëkuptuan procesin e monitorimit dhe nuk pati asnjë rezistencë ndaj vendosjes së disa rregullave të reja shtesë në lidhje me disiplinën në punë dhe i respektuan ato.
- Komisioneri vlerëson rolin e nëpunësve civilë në administratën zgjedhore, të cilët e orientuan procesin e zgjedhjeve drejt standardeve të reja, drejt qetësisë dhe profesionalizmit.

Në përfundim, Komisioneri i falenderon të gjitha institucionet dhe nëpunësit që ishin aktorë të procesit të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor, për përkushtimin dhe bashkëpunimin dhe siguron qytetarët se do të vijojë me përkushtim punën për të siguruar zbatimin e ligjit, për një administratë cilësore, në shërbim të qytetarëve.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**

*Aneksi nr.1    Lista e institucioneve*

<b>Nr.</b>	<b>Institucionet</b>
<b>Kryeministria</b>	
1.	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës Akredituar nga BE
2.	Agjencia e Prokurimit Publik
3.	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
4.	Agjencia Telegrafike Shqiptare
5.	Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
6.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapesinor
7.	Departamenti i Administratës Publike
8.	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave
9.	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
10.	Inspektoriati Qendror
11.	Komiteti Shtetëror i Kulteve
12.	Komiteti për Pakicat Kombëtare
13.	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujrore
14.	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
15.	Agjencia Kombëtare e Diasporës
16.	Avokatura e Përgjithshme e Shtetit
<b>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</b>	
1.	Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
2.	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
<b>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</b>	
1.	Agjencia Kombëtare e Duhan Cigareve
2.	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
3.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Tiranë
4.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnje
5.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë
6.	Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Shkodër
7.	Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Tiranë
8.	Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Shkodër
9.	Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Vlorë
10.	Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve, Elbasan
11.	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës
12.	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve
13.	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë
14.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Kruje
15.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Korçë
16.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Lushnje
17.	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër



<b>18.</b>	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Vlorë
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	
<b>1.</b>	Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentit
<b>2.</b>	Arkivi Shtetëror i Sistemit Gjyqësor
<b>3.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
<b>4.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (Zyra vendore e Shërbimit të Provës: Tiranë, Shkodër, Fier, Durrës, Lezhë, Elbasan, Korçë, Berat, Vlorë, Lushnje, Gjirokastrë, Sarandë, Krujë, Kukës, Mat, Dibër, Kavajë, Kurbin, Përmet, Pogradec, Pukë dhe Tropojë)
<b>5.</b>	Qendra e Botimeve Zyrtare
<b>6.</b>	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
<b>7.</b>	Instituti i Mjekësisë Ligjore
<b>8.</b>	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
<b>9.</b>	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve
<b>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</b>	
<b>1.</b>	Agjencia Kombëtare Bërthamore
<b>2.</b>	Agjencia për Eficencën e Energjisë
<b>3.</b>	Qendra e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve
<b>4.</b>	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera
<b>5.</b>	Sekretariati i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
<b>6.</b>	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
<b>7.</b>	Autoriteti i Aviacionit Civil
<b>8.</b>	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
<b>9.</b>	Drejtoria e Përgjithshme Detare
<b>10.</b>	Instituti i Transportit
<b>11.</b>	Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore
<b>12.</b>	Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
<b>13.</b>	Agjencia Shtetërore për Shpronësimin
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>	
<b>1.</b>	Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit
<b>2.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit (Degët rajonale)
<b>3.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Zyrat rajonale)
<b>4.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
<b>5.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Degët rajonale)
<b>6.</b>	Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore
<b>7.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë
<b>8.</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë
<b>9.</b>	Agjencia Kombëtare Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
<b>10.</b>	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (Degët rajonale)
<b>11.</b>	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
<b>12.</b>	Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve

13.	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
14.	Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
15.	Drejtoria e Përgjithshme e Pronesise Industriale
16.	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
17.	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
18.	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>Ministria e Kulturës</b>	
<b>Ministria e Mbrojtjes</b>	
1.	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (Drejtoritë rajonale: Fier, Shkodër, Korçë, Dibër dhe Tiranë)
2.	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (Qarqet: Tiranë, Durrës dhe Dibër me qendër në Durrës Shkodër, Kukës dhe Lezhë me qendër në Shkodër Elbasan, Berat dhe Korçë me qendër në Korçë Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë me qendër në Fier)
<b>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</b>	
1.	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
2.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Agjencitë rajonale: Tiranë/Durrës/Dibër, Fier/Vlorë/Gjirokastrë, Berat/Elbasan/Korçë dhe Shkodër/Lezhë/Kukës)
3.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit (Agjencitë rajonale: Lezhë, Durrës, Vlorë dhe Sarandë)
4.	Agjencia Kombëtare e Turizmit
5.	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
<b>Ministria e Brendshme</b>	
1.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
2.	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
3.	Administrata e Prefektit të Qarkut Berat
4.	Administrata e Prefektit të Qarkut Dibër
5.	Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës
6.	Administrata e Prefektit të Qarkut Elbasan
7.	Administrata e Prefektit të Qarkut Fier
8.	Administrata e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë
9.	Administrata e Prefektit të Qarkut Korçë
10.	Administrata e Prefektit të Qarkut Kukës
11.	Administrata e Prefektit të Qarkut Lezhë
12.	Administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër
13.	Administrata e Prefektit të Qarkut Tiranë
14.	Administrata e Prefektit të Qarkut Vlorë
<b>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</b>	
<b>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</b>	
1.	Qendra Kombëtare e Cilesisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
2.	Qendra Kombëtare Edukimit në Vazhdim

3.	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
4.	Instituti i Integritimit për ish të Përndjekurit
5.	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetror
<b>Keshillat e Qarkut</b>	
1.	Berat
2.	Dibër
3.	Durrës
4.	Elbasan
5.	Fier
6.	Gjirokastër
7.	Korçë
8.	Kukës
9.	Lezhë
10.	Shkodër
11.	Tiranë
12.	Vlorë
<b>Bashkitë</b>	
1.	Berat
2.	Dibër
3.	Durrës
4.	Elbasan
5.	Fier
6.	Gjirokastër
7.	Korçë
8.	Kukës
9.	Lezhë
10.	Shkodër
11.	Tiranë
12.	Vlorë
13.	Kolonjë
14.	Pustec
15.	Devoll
16.	Polican
17.	Kuçovë
18.	Maliq
19.	Skrapar
20.	Ura Vajgurore
21.	Gramsh
22.	Peqin
23.	Cerrik
24.	Vorë

25.	Shijak
26.	Bulqizë
27.	Malësi e Madhe
28.	Has
29.	Mallakastër
30.	Librazhd
31.	Prrenjas
32.	Mat
33.	Klos
34.	Krujë
35.	Belsh
36.	Patos
37.	Roskovec
38.	Lushnje
39.	Divjakë
40.	Libohovë
41.	Tepelenë
42.	Memaliaj
43.	Përmet
44.	Këlcyrë
45.	Dropull
46.	Pogradec
47.	Tropojë
48.	Kurbin
49.	Mirditë
50.	Vau Dejës
51.	Pukë
52.	Fushë Arrëz
53.	Kamëz
54.	Kavajë
55.	Rrogozhinë
56.	Himarë
57.	Finiq
58.	Selenicë
59.	Sarandë
60.	Konispol
61.	Delvinë
<b>Institucione të Pavarura</b>	
1.	Autoriteti i Mediave Audiovizive
2.	Autoriteti i Konkurrencës
3.	Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet Ish Sigurimit të Shtetit

4.	Avokati i Popullit
5.	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsone
6.	Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
7.	Kontrolli i Lartë i Shtetit
8.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
9.	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
10.	Administrata e Presidencës
11.	Komisioni i Prokurimit Publik
12.	Instituti i Statistikave
13.	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
<b>TOTALI</b>	
<b>200 institucione</b>	
<b>(Kryeministria, 11 Ministri të linjës, 90 Institucione varësie, 12 Prefektura, 12 Këshilla Qarku, 61 Bashki dhe 13 Institucione të pavarura)</b>	